

RAMADAN SOKOLI

KANGËT RITUALE NË TË KREMTET VJETORE
TË POPULLIT TONË

Folklori ynë ruen shumë mbeturina dokesh dhe kultesh të lashta, që shoqënohen me kangë e me valle të posaçme. Gjurmimi i tyre i vlen shumë ditunisë. Për studjuesit e kësaj lame vendi ynë mund të krahasohet me një minierë të pasun ose me një muze të gjallë, ku shikohen fare mirë shtresat e ndryshme të animizmit, magjizmit, totemizmit, fetiçizmit, etj. Edhe sot dëgjohej në gojë të popullit tonë disa fare kangësh, që na sjellin jehonën e kremtimeve të dikurëshme pagane e parapagane.

T'i parashtrosh në një artikull të gjitha këto doke së bashku me repertoarin e tyre, nuk asht punë e lehtë. E për çka të shkruesh ma parë: për *Ko, tendrat dhe Naten e Buznit* apo për *Llazorët* dhe *Shtregullat e Shengjergji* për *Rusicat* dhe *Vangjelijamon* apo për *Dajlinat* dhe *Dordolecin*? — Këtu të përshkruejmë shkurtimisht kremtimet ma kryesore, tue sjellë disa shembuj nga repertori i tyre.

Dihet, se natyra zinte një vend të randësishëm në kultet e stërgjyshëve tanë. Ata adhurojshin diellin, tokën, zjarrin, ujnatin, etj. tue iu true kremtime, flijime, kangë e valle të veçanta, që pjesërisht kanë arrijtë deri në ditët tona. *Kultin e diellit* e kemi ende të gjallë në folklorin tonë si: në përrallat popullore, në gojëdhanat e toponimeve, në doket, në lojnat e fëmijëve, në vetë lokucionet e gjuhës së popullit, veçanërisht në betimet "Për at Diell!", "Për at dritë Diellit", "Diell-po!" — "Diell-jo!" sidhe në emnin e ditës së Diell!

Si në përrallat e gojëdhanat, ashtu edhe në disa kangë popullore, dielli dhe hana përfytyrohen si qenie të gjalla pak a shumë në përngjasim me njeriun. Raste të një antropomorfizmi të këtitillë vërehen edhe në epikën tonë, — siç dëshmon kjo pjesë nga një kangë kreshnikësh:

A kshtu dita e mbrame më paska ardhun-o
Dielli xanë e majet xanë!
Ku e le ndoren more diell?
Ku e le ndoren mori zanë
Po a kjo a besa qi m'patët dhanë?
A po m'gjegjesh more diell?
Pash njetë dritë qi t'flakron n'ballë.

Shtojmë, se shumë kangë dhe vjersha popullore për diellin, e kanë humbë tashma vështrimin e tyre të hershëm; janë braktisë nga të rriturit dhe kanë ngelë vetëm në gojë të fëmijëve si p.sh. ky motiv i qëmtuem në Gjinokastër: (sh. muz. nr. 1) ¹⁾.

1) Nga "Antologji këngësh popullore" — Botim i Institutit të Folklorit — Tiranë 1963.

Ndonëse koha duhet ta ketë ndryshue pa tjetër këtë motiv, tue futë në te elemente të reja simbas kushteve të zhvillimit shoqnor, prap se prap mund të shikohen fare mirë gjurmat e botëkuptimit *animistik*. Por le t'i marrim me radhë kangët ritualistike dhe t'i parashtrojmë së bashku me doket përkatëse.

Simbas kalendarit të vjetër popullor, së pari kemi kangët e kremtimeve pranverore, (Viti i ri, për të parët tanë, fillonte në pranverë me gjethin e ri) ¹⁾ që fillojnë me "Ditën e Verës" (13-15 mars), e cila pritet me gëzim të madh, sidomos nga blegtorët e zonave malore. Vigjiljen e kësaj dite në Dukagjin e në Pukë e quejnë "Nata e Mojt". Që në mëngjes herët, fëmijët dalin tue këndue (sh. muz. nr. 2) ²⁾. Ky motiv, i qëmtuem në krahinën e Lumës nga ekspedita shqiptaro-rumune e vitit 1959, njihet në shumë variante në Shqipëri verilindore. Ja një dhembull nga Peshkopia (sh. muz. nr. 3) ³⁾.

Ore zogu i ferrës	Si na (j)erdh Shëngjergji
Na (j)erdh dita verës	Me sheja për brezi
Dita verës erdh-e	Me sheja për brezí
Dukatin me reth-e	Vjen i miri e i keqi
Dita verës shkoi-e	I miri le t'vijë
Shëngjergji përgjoi-e	I keqi le t'rrijë
	I miri le t'duket
	I keqi le t'hupet.

Kemi edhe variante të tjera që ndryshojnë pak a shumë simbas krahinave.

Po për këtë ditë, fëmijët e rrethit të Pukës dhe të disa viseve të tjera, me kunora shelgu në kokë, dalin e kërkojnë gogla dushku; pastaj, si zanë ndo-një plesht, e fusin në vrimë të goglës dhe e lëshojnë në ujë të rrjedhshëm së bashku me kunorat. Nderkaq vajzat dalin fushave, mbledhin lule dhe stolisin me to dyert dhe dritaret e shtëpive. Në Shqipëri juglindore djemtë mbledhen lagje-lagje dhe, mbasi njeni nga ata ven një kanistër në kokë, shkojnë tue këndue derë më derë (sh. muz. nr. 4) ⁴⁾

O vera vera kokovera	O se na vijnë këto beqarë
Moj zonj'e uruar	Se na vijnë duke qarë
Flen a po je zgjuar?	Me një thes të grisurë
Hiqi moj llozë derësë	Duke, moj rrukullisurë
Erdhi moj dit'e verësë	

1) Siç dihet, gjethi i ri nuk del kudo në të njëjtën kohë, sepse në viset e ngrohta pranvera arrin më shpejt se sa në viset e ftofta. Ky faktor klimaterik pat ndikue në kalendarin e vjetër të popujve indoeuropianë sidhe në vetë datat e disa kremtimeve popullore që nuk bijnë kudo në të njëjtën kohë (fenomen i njoftun për gjurmuesit e folklo-it). Sidoqoftë, për të parët tanë ashtu si për shumë popuj t'Europës, në muajin mars fillonte viti i Ri dhe mbaronte viti i vjetër. Këtë na e dëshmojnë njëjt gjurmë të ruajtuna ndër traditat e popujve të këtij kontinenti, sidomos vetë emnat e disa muajve si p.sh. "shtatori" që s'asht muaji i VII por i IX, "tetori" që asht muaji X ose "nandori" e dhjetori (i XII): — këtë farë emërtimi rendor këta muej e kanë rrujtë pra nga ajo kohë kur viti i Ri fillonte në mars. Në shek. VII (653) romakët e çvendosën datën e vitit të Ri nga marsi në janar. Pastaj kalendarin e vjetër shkoj tue pësue gjatë kohës edhe ndryshime të tjera simbas rrethanave politike, fetare etj. Reforma gregoriane (1582) e përforcoi edhe ma tepër 1 janarin si pikënisje për vitin e Ri. Nga ana tjetër dyndja e otomanëve solli ndikimet e Lindjes edhe në këtë lamë, nga sfera iranike na solli "Nevruzin", pranverën si fillim viti. Për shkoqitje ma të hollësishme shih Rrok Zojzi "Gjurmët e një kalendarit primitiv në popullin tonë" botue në "Buletin i Institutit të Shkencave" nr. 1, f. 85-112, Tiranë, 1949.

2) Nxjerrë nga *idem-ibidem*.

3) Shembujt që do të përmenden pa emnin e mbledhësit, janë qëmtue nga auktori i këtij studimi.

4) Nxjerrë nga "Antologji këngësh popullore".

Edhe ky motiv, që u qëmtue në Starje të Kolonjës nga ekspedita shqiptaro-gjermane e vitit 1957, njihet në disa variante në Toskëni¹⁾.

Po kanistrën ç'e duen djemtë?

Për të futë vezët që ua japin amvisat, të cilave u a kërkojnë shprehimisht me kangë:

Peksime moj peksime	Ashtu dalçi mot me në
Pa na nxir një koqe-vé	Mot me ne gëzuar
	Me djem të martuar.

Si i darovisin me vezë ose me diçka tjetër, vazhdojnë urimet:

Sa lesh mbi tre desh	Sa lule ajo qershi
Aqë bereqet të kesh;	Aqë djem e foshnjëri
Sa lule ajo thanë	Sa qepra ajo kasolle
Aqë djem edhe stopanë;	Aqë nuse punëtore.

Edhe ky motiv, qëmtue në rrethin e Përmetit, i ka variantet e veta në Shqipni të Jugut²⁾.

Në disa vise të atdheut si p.sh. në Elbasan, dita e Verës kremtohet me shetitje jashtë qytetit, me pjesëmarrjen e grave dhe të fëmijëve. Me këtë rast plakat bestytnore përsërisin këtë namatisje: (sh. muz. nr. 6)

Marsh morrat e pleshtat	Ethet e verës
Gjumën e sabahut	Me çakaça derës.

Pothuejse kudo në Shqipni gatuhet për këtë ditë gjellë ose ambëlsina të posaçme. Të shumta janë bestytnitë dhe shortitë popullore lidhun me këtë ditë të shënueme. Po çekim disa nga ma të rëndomt:

Që në vigjiljen e kësaj dite, fëmijët bajnë "larza" ose "verore"³⁾ me fije mëndafshi të kuq, të bardhë e jeshil, i dredhin së bashku, i lidhin në degë trëndafilësh dhe i lanë aty që të vesohen deri në të nesërmen.

1) Një variant, botue në "Visaret e Kumbit" vëll. XIII f. 129, paraqet këtë ndryshim te vargjet e fundit:

Të gostit këto beqarë	Duke rënë tumarasë
Që po shkojnë duke kënduar	Me një thes të grisur
	Duke rrukullisur.

Një tjetër variant, qëmtue në fshatin Brezhan (rrethi i Këlcyrës) nga ekspedita shqiptaro-gjermane, ka këtë brendi fantastike: (sh. muz. nr. 5).

Vera-vera kokovera	Karkalec o derë-zi
Një pulë që paç e thera	Ç'ha ti e ç'pi ti,
Gjithë miqtë se ç'i ftova	Ha mish gjarpëri
Karkalecin e harrova.	Pi uj frashëri.

2) Fëmijët e Lushnjës ligjërojnë tue trokatë me kumonë:

Toli, tomoli,	Lesh, lesh, mitrodesh
To gajtani, pelivani	Aq bereqet të kesh
Shkoi çela nëpër ne	Oj halle, oj teze
As na jep një koqeve	Koqeven e pulës zezë
Ju dhënt'zoti tre pënd-që	Oj teze, oj hallë
Tre pënd që, tre pënd buj	Koqeven e pulës bardhë.

Dhe kur ndonjë amvisë i përcjellë pa gja, vazhdojnë kështu:

Sa gjëma ka murizi	Sa gjëma ka lajthata
Aq xhung të ket kurizi	Aq pislëqe të ket' vatra

3) Verojka — e quejnë në Përmet, guduverë — në krahinën e Himarës.

Në mëngjesin e ditës së Verës, e marrin larzën s'andejmi, e lidhin në kyç të dorës dhe e mbajnë (të mbulueme "që mos ta shohë dielli") deri në ditën e Shëngjergjit (në Gegëni), ose, derisa të shohin dallëndysheën e parë (në Shqipni të Jugut). Fëmijtë e disa viseve të Gegënisë e hudhin larzën në ferrë tue ligjërue këtë distik:

Ma sa mban ujë ferra
Aq të këqia pastë trupi i im

ndërsa fëmijtë e Toskënisë e varin "veroren" në dega trëndafilesh tue ia truce dallëndysheës (sh. muz. nr..7)¹⁾

Dallëndyshe faqe-kuqe
Merr veroret shko në det
Sill tri qerre me shëndet!

Edhe ky motiv ka variantet e veta si në Shqipni ashtu edhe jashtë kufijve t'atdheut. Ja një shembull nga Bilishti i Korçës (sh. muz. nr. 8)²⁾

Interesant asht edhe një tjetër zakoni i fëmijëve në disa vise të Shqipnisë së Jugut: ditën e Verës dalia shpirtitë lëndinave: mbi ndonië vend me haxh të njomë, vendosin kambën e djathtë dhe presin me thikë një plis në formë e saj; si e nxjerrin plisin kallop nga toka, hudhin në gropëzën e porsahapu disa thërrime buke ose kokrriza krype, të cilat i mbulojnë prap po me at plis. Vallë, a mos kemi të bajmë këtu me një mbeturinë nga hijimët ndaj Tokës?

Në këtë rast duhet vu në dukje, se, për ditën e Verës, populli i shmanget çdo shamate që "të fillojë moti n'ujdi".

Pothuejse në çdo krahinë të Shqipnisë, simbas zakonit të vjetër, kah muzgu i kësaj dite, ndizen nëpër ara zjarre me dëllinja, kashta misri ose duhani. Në Malësi të Madhe, thonë se këto zjarre i ndezin "për me djegë koret". Po ç'janë koret? Simbas thanieve të pleqëve, koret na qenkan shpirtina të këqij që duhen zbutë³⁾.

1) Në rrethin e Tiranës ligjërojnë kështu:

Veroret në kënetë
Morra e pleshta në mal të shkretët.

2) Janë të njohuna variantet e bukura të këtij motivi te arbëreshët e Italisë, variante që na kujtojnë γελοιοποιεσθαι e folklorit grek sidhe një vjershë të Ateneut (VIII, 360 b).

Nga libri i A. M. Cirese-s "Canti popolari delle colonie albanesi del Molise", botue në Rieti me 1957, po çekim vetëm këtë shembull që arbëreshët e këndojnë në dasma:

Alandishja halidone Mos do vijë ka shpia jonë
Ku do vëç të bëç folë? Alandishja halidone?

3) Me sa duket, këtu kemi të bajmë me një mbeturinë të kultit dioniziak, sepse kjo na kujton "Anthesterien" e Greqisë së vjetër. Dihet, se dikur në Athinë ditën e tretë të Anthesterisë ndiznin zjarre për të zbutë shpirtinat e këqij, tue ligjërue këto fjalë: "Përjashta o Kore se Anthesteria mbaroi". Simbas mitologjisë greke kore asht e njejtë me Prezerpinen, e cila na paska qenë një vashë e bukur që çë rrëmbye na zoti i të vdekunve, Plutoni, kur ajo po mbli-dhite lule te kroni i Aretuzës. E ama e Kores, Demetra, u dëshprue shumë dhe e mallkoi botën. Nga nama e saj u thanë bimët dhe u shkretue toka, prandaj për t'a ndreqë, ndërhyri Zeusi pranë Plutonit, i cili pranoi t'ia kthejë vashën s'amës me kusht që ta merrte prap nga 4 muej çdo vit. Ky mit simbolizon qartë zgjimin e pranverës mbas letargjisë së dimnit, përtrimjen e blerimit dhe prap venitjen mbas 8 muajsh. Përdorimi i zjarrit ose ujit në këtë rast janë mbeturina nga shortitë e "pastrimit" (lat. "lustratio") që ushtroheshin sidomos në prak të dy stinëve.

Georg von Hahn, i njohun si ati i studimeve albanologjike, në veprën e tij "Albanesische Studien", botue në Jenë me 1854, aty ku tregon se "si e përzanë morten në Selicë" thotë midis të tjerash: "Të shtunën", para pashkëve, djemtë i hudhin pishat në lum me këto fjalë:

Në disa vise të Gegënisë, marrin una zjarri, i mbështjellin me rema dushku, fier ose kashtë dhe me to' në duer vrapojnë me britma gazmore përpjetë e teposhtë kodrinave, tue i flakëruet në erën e muzgut. Shembullin ma tipik e kemi në "dajlinat" e krahinës së Matit: fëmijët thurin vrvavashka me krande të thata e thupra hardhie të mbështjelluna me kashtë dhe të lidhuna me kurrpën në formë rrethi; me 'to në duer ngjiten majë kodrave, u japin zjarr dhe i rrotullojnë tue bërtitë:

Dajlinat e pranverës
Marshin ethet e gjithë verës.

Nga larg, këto vrvavashka që flakërojnë natën, duken si xixëllonja të shpërndame në luginë të Matit.

Malësorët e Dukagjinit, kur mblidhen rreth votrës në mbramjen e kësaj dite, si hanë darkë, lidhin shtrigat (!), ngjilicat, llugjat, rrollçat, gjarpijt e krymat e tokës, shkurt, të gjithë damtorët e dukshëm a të padukshëm dhe ja se si: i zoti i shtëpisë mer një fije pe leshi të zi dhe lidh nga një nyjë në vargue të votrës tue thanë:

Lidhe Zot
E nata e Mojt
E dita e verave:
Un pak e Zoti shumë
Po i lidhim shtrigat! . . .

Pastaj me të njajtën mënyrë e më të njajtat fjalë vazhdon për llugjat, krymbat, gjarpijt, etj.

Më 25 mars (sipas kalendarit të vjetër më 14 mars) kemi ditën e Vangjelizmojt, ditë në të cilën zbohen zvarritësat e ndryshëm me një ceremoni të posaçme. Fëmijët e shumë viseve të Shqipnisë së Jugut, varin në qafë zile o kumona dhe shkojnë derë më derë tue bërtitë:

Um, um baderum
Ikni, ikni o gjarpënj
Se po vjen Vangjelizmoj
Pa na vret, pa na pret
Pa na hedh në përrue
U han qentë e tërbuar!

"Oj Kore, ne po të hedhim në lum si këto pisha që mos të vijsh kurrë ma" . . ."Disa thonë — vazhdon Hahni — se kjo ceremoni ka për qëllim të përziej dimnin. Duhet ta dijme se Kore-ja asht një shtrigë e keqe që ha fëmijët e vegjël dhe figuron edhe në përrallat e vendit. Për të përkujtue ngjitjen e Kores (Prozerpinës) nga bota e të vdekunve, dikur, pendarët e Italisë jugore laheshin me këtë rast në ujë të detit, ashtu siç veprohet edhe sot në disa fshatra kalabreze të Vaccarizzo-s dhe S. Giorgio Albanëse: në vigjiljen e festës së të Shëlbuemit disa fshatarë arbëreshë zbresin në bregdet ku qëndrojnë gjithë natën dhe të nesërmen sapo gdhihet dita, futen në ujë tue ligjërue formula magjike (shih Gina Algranati i Calabrie f. 13-14 ed. trevisini — Milano). Pak a shumë kështu veprojnë edhe fshatarët e disa viseve të Shqipnisë së Mesme që zbresin në Shkozet të Durrësit natën e 14 gushtit, për t'u futë në det të nesërmen në mëngjes. Edhe këtu kemi një "transfert" datash që siç u tha ma nalt asht një fenomen i rëndomtë në kremtimet e shumë popujve."

1) Një variant i këtij motivi, qëmtue në Rehovë të Kolonjës nga ekspedita shqiptaro-gjermane, paraqet këto ndryshime:

Ikni, ikni o gjarpënj
Se na vjen Vangjelizmoj
Pa na vret, na shkurton
Dhe në gropë na mbulon.

Tue ba zhurmë e tue tingëllue zilet e kumonat, fëmijtë përmetarë futen nëpër shtëpi, sidomos në katoqe e në qilare ku mbahet drithi, bylmeti dhe ushqime të tjera. Ky zakon ndiqet kryesisht në Shqipni të Jugut. (Gjurmë të kësaj mbeturine pagane kemi edhe tek arbëreshët e Kalabrisë, — siç dëshmon ky shembull i qëmtuem në Shën Benedikt Ullana (nga Nik Fofu).

Ikni mi, ikni zhapi
Se është'e vjen Marsi
Me gjith'ato hajdhi

sidhe ky shembull që i truhet amvisave koprace (idem-ibidem)

Mit e zhapit e gjithënisë
U mbjodhëshin gjith' te kjo shpi.

Me sa duket, dikur, ky zakon, që ma vonë u shartue me elemente kristiane, ka qenë përhapë në shumë popuj t'Europës¹). Pikërisht me këtë periudhë të vitit lidhet një gojëdhanë shumë e njohun si në folklorin tonë, ashtu edhe në traditat e popujve të tjerë të Mesdheut: gojëdhana meteorologjike e ernave që fryjnë me furi, gjoja, qëkurse Marsi i zemruem u kthehe dhe kërkoi nga:

Prilli em vlla
M'i nep tri dit uha
T'a ngrij plakën me gjithçka ka.

Llazoret, kremtime pranverore që kanë shumë motive në folklorin tonë, në disa vise të Shqipnisë së mesme janë, si të thuesh, shenjë e pranverës, — siç na e dëshmonjnë vetë lokucionet popullore²). Si për kremtimet e tjera, ashtu edhe për Llazoret, mbas darke, fëmijtë, me shporta të stolisuna, shkojnë tue këndue derë më derë (sh. muz. nr. 9).

Llazole, llazole
Fali Zotit fali-e
Qi na bani neren-e
Neren e ksaj veres-e
Oj halle o topalle
Koqeven e pulës bardhë

Oj teze oj reze
Koqeven e pulës zezë
Fusha nëpër fusha
M'u grisën brekushat
Ferra nëpër ferra
M'u grisën opengat.

Ky motiv u muer nga fëmijtë e Shijakut. Në rrethin e Kavajës llazoret këndohen kështu: (sh. muz. nr. 10).

1) Të rinjtë e disa viseve të Zvicrës për të dielën e parë të marsit ("Chalanda Mars") qarkullojnë arave, sillen rreth puseve, mullareve të sanës etj. tue këndue, bërtitë e tue zhangllue kumonët; ndërsa në disa vise të Gjermanisë këtë e bajnë për festën e qirijve (d.m.th. me 2 shkurt). Veprime-pak a shumë të kësilla, për zbatimin e dimnit, shpirtënvë të këqij, zvarranikëve, kandrrave të damshme etj. bahen edhe në Traki, në gadishullin Iberik, në Sardenjë e në Europën qëndrore (shih Francesco Alziale: "Contributi al concetto di tradizione" në "Atti del VII congresso nazionale delle tradizioni popolari" — Firenze 1959). Kumonat ("tintinnabula") dhe zhangllima e tyne (elemente karakteristike për disa kremtime pranverore si p.sh. llazoret, karnavalet etj.) dikur përdorëshin në ritet bujqësore për qëllime apotropike.

2) "Kanë dalë llazoret" dmth. "erdhi pranvera".

O Llazore, llazoriske
 Koqeven qi ban lariske
 Moskopalla xufkate!¹⁾
 Dhe limoni shpatat-e
 Shpatat e të Zotit-e
 Ej zot e jarabi
 Jepi sot-o ksaj shtëpi
 Me samune dhe qahi
 Me livere lahuri
 Hej Zoti ktij konaku
 Na qit gja se na ra barku
 Në m'a dhanç një kokërr ve
 Çuni t'marr't një nuse t're
 Në m'i dhanç nja dy tre teka
 Efendi-o tunjatjeta

Në m'i dhanç një dor me gjema
 Çuni juej ju xan't kalema
 Në m'a dhanç një kokërr palë
 Zoti ju ju dhanç një djal
 Oj halle oj palle
 Koqeven e pulës bardhë
 Oj teze oj reze
 Koqeven e pulës zezë
 Jan llazoret mun ke porta
 Na qit gjā se na zu nata
 Jān llazoret mu ke dera
 Na qit gjā se na erdhi vera
 Jan llazoret mu ke praku
 O efendi t'u shtoft' oxhaku
 Hu sot e hu mot
 Qesja e jote met't plot.

Së bashku me kangët, "Llazoret" e rrethit të Kavajës, çojnë në shtëpitë e farefisit plisa me bar të njomë. Ndërkaq, nikoqiret, si kudo, dalin e darëvisin tue futë dy vezë në shportën e tyne e tue marrë prap një vezë s'andejmi. Për këtë, "Llazoret" falenderojnë me urime të këtilla:

Sa lesh mitrodesh
 Aqë bereqet të kesh
 Sa lule mbi Tomorr
 Aqë dhen e dhi n'oborr
 Sa lule mbi çardhak

Aqë nuse në duvak
 Sa lule mbi qershi
 Aqë trima në shtëpi
 Sa lule mbi kasolle
 Aqë nuse furkatore²⁾

Urime pak a shumë si këto vërehen edhe në llazoret e viseve të tjera, natyrisht me ndryshime krahinore, por, megjithatë, shquhet uniteti ynë etnik në vetë bashkaritë e motivit kryesor. Ja një shembull nga Preza e Tiranës: ³⁾

Sa furka n'at kasolle
 Aqi nuse punëtore
 Sa lesh m'ata desh

Aqi bereqet prej nesh
 Sa lush m'ato dush
 Aqi bereqet prej jush.

1) Kuptimin e errët të këtyne vargjeve na e sqaron deri diku ky variant, qëmtue në Mokër të Pogradecit nga ekspedita shqiptaro-gjermane:

O pëllumb-o pëllumbo

Llazole-llazole

Mos na e pe Llazarë
 Këtu drejt ka shkuarë
 Ne gur'i lëmuarë
 Ku limonin shpatatë
 Shpatat e Sotiritë

„ „
 „ „
 „ „
 „ „
 „ „

siedhe ky variant leskoviqar :

Llazari Shën Llazëri
 Mos patë llazuarin
 Ne kroi i farkuarë
 Që fërkonte shpatënë
 Shpatën e të Zotitë, etj. (idem)

2) Qëmtue në Fier nga ekspedita shqiptaro-gjermane.

3) Nxjerrë nga "Visaret e Kombit", vëll. XV, Tiranë 1944 — Mbledhë nga Shaban Sheshori.

Ndonjëherë, kur rastis t'i përcjellin "llazoret" pa u dhurue asgja, fillojnë mallëkimet:

Sa gjeth m'ate kumbull
Nesër gdhifshi gjith garrumbull
Sa gjeth m'atë fik
Nesër gdhifshi gjith calik . . .!)

Ja dhe një variant nga rrethi i Këlcyrës (katundi Brezhan):²⁾

Llazeri shën Llazeri	Se s'i kemi ngenë
Foli dhi ordhis-e	Se do vemi në të tjerë
Të zonjës shtëpis-e	Të na japin koqe-vé
Të na dalë në shkallë	Ti moj që s'na dhe venë
Se ç'i kam një fjalë	Të bëftë bufi folenë
Të na nxjerrin venë	

Do t'ishte një punë interesante po të hyjshim me shkoqitë vështrimin e errët të disa fjalëve, si p.sh. — në vargun e shembullit të masipërm "foli dhi ordhis-e" ose në tekstin e shembullit që vijon: ³⁾ (sh.muz. nr. 11). Mbrenda në Korçë, përveç fëmijëve, edhe gratë (zakonisht ciganët) dalin për llazore. Simbas zakonit ato dalin me një kukëll ("nuskë") prej lecke tue këndue (sh. muz. nr. 12):

Edhe moti me shëndet
Llazoret na gjeçin gëzuarë
Dhe N. N. na punon
Llazoret e gjeçin gëzuarë

Llazole-llazole

Në tekstet e disa llazoreve kanë depërtue elemente kristiane si p.sh. Shën Ilia në këtë motiv nga Lushnja⁴⁾.

Imi, imi Llazoni	O kush gëzon Llazonin-o
O i zoti Shëndëlli	E gëzoftë perëndia
Rrok zojen për qafet-o	Ju mbusht vatra me fëmi
Me djathë në napët-o	Ju mbusht xhepi me flori.

Përveç Shën Ilisë, në vjershat e llazoreve, kanë depërtue edhe elemente ma të reja, siç mund të vërehet në këtë motiv nga Tirana : (sh. muz. nr. 13).

Duerët e llazoris-e	Në më dhanç një dor'oriz
Hangshin gjat'n e motit-e	Cuni tat t'u baft'hafiz
A po del e a ç'po thue?	Sa zhur n'atë rreke
Se veziri më ka çue	Aqi kova plot me vé.

Në traditën popullore t'arbëreshëve t'Italisë, disa llazore janë veshë krejtësisht me një cipë fetare kristiane: natën, tue trokatë derë më derë,

1) Nxjerrë nga "Visaret e kombit", vëll. XV. Tiranë, 1944. Mbledhë nga Shaban She-shori.

2) Mbledhë nga ekspedita shqiptaro-gjermane.

3) Mbledhë nga K. Trako në Boboshticë (rrethi i Korçës).

4) Mbledhë nga ekspedita shqiptaro-gjermane.

ata këndojnë për ringjalljen e Shën Lazrit¹⁾. Shembulli që po sjellim këtu dëshmon, se ndikesa kishëtare shquhet shumë jo vetëm në vjershë por edhe në muzikë (sh. muz. nr. 14)²⁾. Duhet dijtë se ngulmënia e arbëreshëve për të rrujtë këto kangë fetare lidhet me ngulmëninë për të rrujtë kombësinë e tyne, sepse feja i dallonte ata nga italianët katolikë. Shembuj llazoresh me karakter liturgjik kristian kemi edhe në vendin tonë, por këta nuk paraqesin vlerën shkencore e shoqërore të motiveve arbëreshe.

Sa për origjinën e llazoreve me tipare bujqësore, mund të themi, se ajo humbet në errësinën e së kaluemes. Siç u tha ma nalt, në disa vise të Shqipërisë se mesme dhe të jugut, llazoret dalin me një kukëll (dimensionet e saj ndryshojnë) prej lecke dhe me te në dorë vallëzojnë e këndojnë:

Luaj lule luaj
Në dorë të Zotit
Zoti qysh punonte
Qese, hasë numuronte
Djem e nuse urdhëronte

Darovit llazuar
Ashtu dalçi gëzuar
Si sot e për shumë mot
T'u mbushtë qasja plot³⁾

Kjo kukëll, mbeturinë e kultit dioniziak në folklorin tonë, dikur përfaqësonte shpirtin demoniak të dimnit, por me kohë e humbi këtë vështrim të lashtë.

Tek arbëreshët e Kalabrisë edhe kuklla ritualistike (ose "kreshma") asht mveshë me një cipë kristiane: ato në fillim të kreshmës e varin kukllën ndër dritaret e shtëpive. Nga paraqitja e jashtme përngjason pak a shumë me kostumin karakteristk të grave arbëreshe; në njenën dorë ka një furkë dhe në tjetrën boshtin për të tjerë lesh. Tek kambët ka shtatë pupla pule, të cilat ia shkulin nga një për çdo të dielë, deri sa të sosen për pashkë; atëherë i heqin kukllat nga dritaret se kreshma ka mbarue.

Interesante asht kjo kangë llazoresh qëmtue në Podgozhan të Mokrës: ⁴⁾

Mblidhi
Mblidhi moj çupa mblidhi
Të vemë
Të vemë për manushaqe
T'ia vemë Lla

T'ia vemë llazorit në faqe
Dy në fa'
Dy në faqe një në ballë
Vanë
Vanë moj lule vanë

1) La notte del venerdì che precede la domenica delle palme, si veste tuttora un uomo con una cappa e camicia che sia di color bianco ed accompagnato da altri va per le porte dei fedeli, cantando con musica semplice e patetica una canzone che contiene il racconto del miracolo della resurrezione di Lazzaro", — nxjerrë nga G. Crispi "Memorie storiche di talune costumanze ecc. Palermo 1853.

2) Nxjerrë nga F. Falsone: *I canti ecclesiastici greco-siculi* — Padovë, 1936. Nga kjo kangë patetike po çekim edhe strofën e mbrame:

O ku t'na gjegjij
Patçit harë
Ejani, sillni
bjerni ato vë

Duket se dhurata e vezëve që mblidhen me kangë tradicionale nga shumë popuj të botës, dikur kishte një vështrim simbolik. Simbas bestytive popullore veza paska disa veti ogurmira, sidomos kur ngjyhet me bojë të kuqe. Ndoshta për këtë arsye që në kohët e lashta popujt e Azisë dhe t'Europës përdorshin vezët e ngjyeme për kremtimet pranverore: p.sh. hebrejtë për ekuinokin e marsit, persianët për "Nevruz" (21 mars) etj. Disa dijetarë kundrojnë në këtë zakon mbeturina besimesh parake simbas të cilave veza përmban një farë jetë në vet-vehte, madje përmbaka esencën hyjnore, prandaj popujt e hershëm të mesdheut kremtojshin me të përtrimjen e natyrës dhe të fuqisë së saj prodhuese (shih Philippe Cirey: *La Religion de l'Encienne Egyppte* f— 212-220 — Paris 1910)

3) Qëmtue në Podgozhan të Mokrës (rrethi i Pogradecit) nga ekspedita shqiptaro-gjermane.

4) *Idem-ibidem*

S'ëmësë
S'ëmësë moj i thanë
Hëngri
Hëngri, lule, hëngri

Gjarpri të'
Gjarpri tët, moj, bijë
— O n'e hëngri u shëroftë
Trimi u trashë, moj - goftë.

Ky motiv, që njihet në disa variante në rrethin e Korçës¹⁾, duket se asht një shartim i *Llazoreve* në *Rusica*, siç dëshmon mbrendia e njenës nga këto variante, që ban fjalë për një çift të varrosun në majë të Malit të Thatë.

Rusicat krenthohen me një repertor kangësh të posaçme, diku para e diku mbas pashkëve, kryesisht nga gratë dhe fëmijët. Në disa fshatra të rrethit të Korçës, veshin një vajzë të vogël si nuse dhe e shetisin me një shportë në dorë, tue këndue derë më derë (sh. muz. nr. 15).

Rusa²⁾ papusa
Nā dërgoi Rusica
Për një doçkë miell
Të bëjmë kulaçe
Dil moj faqe-bardhë
Mot me një djalë.

Siç thuhet në vjershën e këtij motivi, ata kërkojnë kryesisht miell e të-lyne për të gatue pogaçet e rastit. Në disa fshatra të këtij rrethi si Dishnicë, Rëmbec, etj., për *Rusica* sajojnë një farë manikeni ("nuskë") prej balte, e vendosin mbi një tezgë dhe e mbulojnë me pëllurë siç mbulohen të vdekunit. Në fakt kjo "nuskë" përfaqëson "nënë e diellit" e cila ka vdekë. Kah muzgu shkojnë për ta varrosë jashtë fshatit, anës së lumit. Si hapin një gropë, vendosin "nënë e diellit" dhe e qajnë me këto fjalë:

Nëno moj nëno
Ardhi dielli e nuk të gjeti.

Për shpirtin e saj ndajnë grunë ose misër të ziemi; pastaj gropën e mbulojnë. Ky ritual, i njohun edhe në traditat e disa popujve të soqëm e të moqëm (si p.sh. egjiptianët, grekët, sllavët³⁾ etj.), simbolizon stinën që po ikën. Me sa duket, ky kremtim i lashtë, ka lidhje me "rosalie-t" romake: vetë emni "rusica" vjen nga latinishtja vulgare "rosalie" që d.m.th. "festa e trëndafilëve".

Dihet, se në kultet pagane të shumë popujve t'Europës, trëndafilja ishte një element i randësishëm jo vetëm për zbukurimin e kremtimeve, por edhe për cilësitë magjike që ka kjo lule. Dihet, gjithashtu, se romakët krem-

1) Nga M. Kuteli "Këngë e brilma nga qyteti i djegur" — Tiranë — 1944 po sjellim këtu vetëm këtë motëzim;

O Rïstostanesti	Trimi zografiste
Rïstozi bëke një kishë	Vanë s'ëmës i thanë:
N'atë kishë ç'paskë mbrenda o lele	— Hëngri gjarpri tëtë bijë
Qenka trimi edhe vasha	— N'e zu gjarpri u sheroftë
Vasha na qëndiste	— N'e zu trimi u trashëgoftë

2) Me emnin Rusa ose Rusica populli i disa viseve të vendit tonë nënkupton një qenie të mbinatyrëshme. Dikur, në këto raste, ishte e adaluceme me ngranë peshk nga frika se "të hante Rusica".

3) Në folklorin bullgar kjo kukëll njihet me emrin "gjerma" dhe mbahet si mbeturinë e kulteve thrakase; shih Prof. M. Arnandoff: Die Bulgarischen Festbrüche — Leipzig 1917 f. 47-50

tojshin "rosalie-t" për nder të të vdekunve, që përfaqësoheshin nga lulet. Për këtë festë ata nuk kishin një ditë të caktuar, por, natyrisht, binte kurdoherë në stinën e luleve. Mbeturinat e këtij kremtimi në folklorin tonë dëshmojnë, se, edhe për të parët tanë, së bashku me përtërimjen e natyrës, ringjallshin përkohësisht shpirtat e të vdekunve. Kështu shpjegohet edhe përzimja e kangëve dhe e valleve me vajtimet në repertorin përkatës.

Siç u tha më lart, dita e luleve (rusicat) shpesh herë ngatërrohet me Lazoret. Ja një kangë e njohur që këndohet nga vajzat e rrethit të Pogradecit, kur dalin në mal për të mbledhë lule:

Vijnë vashat valle-valle
Gushë, gji stolisurë
Një pëllumb një sy sorkadhe
Na vjen m'e mbollisurë
Shoqe-o në bregëza
Më mirni edhe muë-za
Nër pyje korinjëza
Në mos diçka të bëj tufë
Më lini moj atjenë

Në u pyet njeri për mua:
Ç'u bë flok-balasheja
I thoni në një-përrua
E zu gjarpërusheja
I thoni e hëngri krymbi
Atë bel-këputurën
Nd'e zu gjarpri u shëroftë
Nd'e zu trimi u trashëgoftë!

Mbeturina të këtij kremtimi kemi edhe në viset e tjera të Shqipnisë si p.sh. në malësi të Elbasanit, në malet e Veriut etj. Në Dukagjin e quajnë "*E diela e luleve*", ose "*Dita e endel*" (prej foljes "me u endë") ose "*dita e maranajve*". Për këtë kremtim, që atje bie ditën e Larit, mirditorët stolisin kokat dhe trupin me lule, të cilat madje i çojnë në kishë për t'i bekuar. Gjurma të këtij kremtimi kemi edhe te arbëreshët e Italisë².

Këtë zakon, përveç nesh, e kanë edhe disa popuj të tjerë. Vende-vende rusicat janë përzije me Rrshajet (Pentekoste³). Sllavët, në javën e ashtuquajtur "rusalskaja", bajshin përkujtime në vorreza⁴. Deri në shekullin e kaluar, në Rusi bajshin kuklla prej kashte, të cilat i digjshin ose i varrosnin. Mbeturina të një riti të këtillë janë gjurmue në fshatrat e rajonit Brijanski deri rreth vitit 1949 nga L.V. Kullakovski.

U pa se Rusicat kremtohen diku para e diku mbas Pashkëve që, siç dihet, reforma gregoriane (shek. XIII) i pat caktuar për të dielën e parë mbas hanës së plotë të 21 marsit e që prandaj lëvizin midis kësaj date dhe 26 prillit. Në zanafillë kjo ishte një festë pranverore që ujdisej me ringjalljen e Atis-it, Adon-it sidhe të disa hyjnive të bimësisë, ndërsa simbolas Biblës përkujtonte kapërcimin e Detit të kuq nga hebrejtë (Esodi kap. XII). Ma vonë u shartue në kultin kristian por megjithatë nuk i u zhduk nënshtresa e vjetër, siç mund të vërehet në disa doke e kangë popullore. Këtu po çekim ve-

1) Nxjerrë nga M. Kuteli, *ibidem*. Me sa duket te ky shembull kemi të bajmë me një rast "dushendent" nga letërsia artistike në traditën gojore.

2) Në Odonia Albanese, Palazzo Adriano etj. të rihtë e posamartuem, me këtë rast varin në balkon kunora lulesh të verdha që dalin fushave (Crysantemum coronarium), të lidhuna me kordela ngjyra-ngjyra. Tue mbledhë këto lule, këndojnë disa kangë të veçanta (shih Luigi Sorrento: *Isola del Sole*, f. 60, ed. Trevisini — Milano). Që në vitin 1854 monsignor Crispi shkruente se arbëreshët e Italisë e kanë zakon me dalë për lule një natë nga fundi i muejit prill. C. Serembe ne "Pasqua nei nostri villaggi s'aveva l'uso di festeggiare con danze, canti e spari; queste feste chiamavansi *Rusale* (shih C. Serembe: "La Patria nei canti popolari albanesi" — Cosenza 1889)

3) Në Dhiatën e vjetër kjo paraqitje si festë e korrijes së grunit (Esodi XXXIV); pastaj gjatë mesjetës u përzije me një festë pagane të pranverës. Në kishen Ortodokse, kremtimi i Rrshajeve u fut nga Andrea i Kretës.

4) Siç dihet rusallkat e folklorit rus janë orë ujnash dhe pyjesh (pak a shumë si kshetat; si floçkat tona).

tëmd s a motive interesante nga tradita e arbëreshëve t'Italisë. Në mesnatën e vigjiljes së pashkëve, të rijtë e Frashinetit dhe Ejaninës shkojnë tue këndue nën dritaret e shtëpive të përgjumuna këtë kangë të qëmtueme nga B. Bilota :

Gjegjni, vallaz, somenat
Diellja e Pashkvet na u di!
Ju mos rrini më ndë shpi

dhe pastaj vazhdojnë me këtë kangë shpotie.)

Kush e tuar ²⁾ e kush shtuall
Kush e ka nd'at argali³⁾
Le t'hinjë mbrenda ndë se duall
E u mbullitë mbrenda ndë shtëpi
Le t'rrinë pështjelë me një llunxuall⁴⁾
Kush e ka nd ata mitare⁵⁾
Ndër se prona hëngër derkun⁶⁾
E ne më nëng ka që t'harë⁷⁾
Le t'zerë shalët bashk me xerkun⁸⁾ . . .

Të nesërmen kah muzgu del e qarkullon rrugëve një grup burrash, të mbuluem me çarçafa të bardhë e të shternguem në brez me rrypa të zez, me fytyra të mertisuna si morde, me lëkura portokalli në gojë, me shporta, me kocka, me kafka të vdekuni e me një drapën të madh ndër duer, ndalojnë njerëzit dhe i ftojnë m'e puthë kafken tue thanë: "kujto se ke të vdeç!"⁹⁾ — ose këtë formulë:

"Pra ç'bredhmi e thomi gjith kem vemi
Tek atrat vanë, me cilt do t'jemi⁹⁾

Si t'erret nata ata zhduken tue këndue këtë motiv të gëzueshëm:

Trima, shok, ni¹⁰⁾ që t'gjall jemi
Kendojmi e helmet na mos remi¹¹⁾
Kush na thot se njera mot
Jemi t'gjall gjith si sot!¹²⁾

Pastaj shkojnë e urojnë grupe-grupe nëpër shtëpitë e njeni tjetrit, ku gostiten me pije, pemë, ambëlsina ("kulaçe") dhe sidomos me vezë të ngjyeme. Tue dalë s'andejmi falenderojnë me këtë kangë:

1) B. Bilota: Zakonet e Frasnitës — cit. sac. E. Giordano në "Folklore Albanese in Italia", botue në Ejanina me 1957

2) Nga fjala me tjerrë d.m.th. pëlhurë

3) tezgjah

4) Nga italishtja "lenzuolo" — çarçaf dysheku

5) në liq

6) derrin

7) E tashti s'ka ma se çka të hajë

8) Nxjerrë nga *idem-ibidem*.

9) d.m.th. të gjithë kemi për të shkue atje ku vajtën etnit tanë

10) tani —

11) vërejme

12) Nxjerrë nga *idem-ibidem*

Neve kush na bëri nderë
 Akuavit¹⁾ na dha për verë
 Po si sot edhe nga herë
 Shpia tij, mos pastë vrër
 Shoku in mir e shkoftë
 E gjith bilt ai martoftë etj.²⁾

Një nga kremtimet popullore ma të bukura, që pritet e përcillet në stinën e pranverës me një repertor të pasun kangësh e vallesh të posaçme, asht *Shëngjergji*. Ky kremtim rrjedh nga një mit bujqësor që ka lidhje me kultin e diellit dhe që kristianizmi e pagëzoi ma von me këtë emën. Shëngjergji nderohet dhe ponitet në mënyrë të veçantë nga fshatarësija. Ky asht pajtori i shumë katundeve të vendit tonë. Simbas gojëdhanavë të vjetra, ky kishte vra kuçedrën damtore e shpëtue popullin prej saj (ky motiv lidhet me shumë mite të lashta si p.sh. me Horo-n e egjiptianëve ose me ate të Herkulit, Perseut, Belerofontit, Tezeut, Sugurtit etj.)

Pothuajse në çdo krahinë të Shqipnisë, populli zgjohet shumë herët këtë ditë: thonë, se s'asht mirë me të gjetë Shëngjergji në gjumë. Gratë shkodrane, pa lindë ende dielli, zgjojnë fëmijët tue i qëllue me degë të blerueme; ato dalin jashtë me vrap, rrokullisen në bar të njomë, pastaj lajnë sytë me ujë të freskët pranë ndonjë peme kokërr-kuqe (si shegë, thanë, etj.) ose pranë trëndafiles³⁾. Këtë ditë nuk lihen dyer e dritare pa stolisë me degë të blerueme e lule, bile deri edhe enët e bylmetit, vathët e bagëtive, etj. Malësorët e veriut ngulin dega shelgu të bardhë deri në mes të arave, sepse sig thonë "atë ditë e njëj toka të zon". Me kurpna të njoma, bujqit e shumë viseve të Shqipnisë, sajojnë kunora për kokë ose për brez (për mos me u dhimbtë mezi gjatë prashitjeve!). Në disa fshatra të Toskënisë dalin kopshtijeve tue tingëllue zile e kumonë për të zbutë s'andejmi krymbat që damtojnë bimët dhe pemët.

Vjershat dhe kangët popullore për ditën e Shëngjergjit janë të shumta. Këtu po çekim një motiv magjik nga Picalli (rrethi i Tiranës), ku mund të shikohen disa bestytni popullore, sidomos lidhun me rritjen e flokëve që ushtruka kjo e kremte.

O Shëngjergji bardhë
 Njishti motmot m'gjeç me'i djalë
 O Shëngjergji mushtullu
 Sa ky li
 Të bahen flokt'e mi
 O Shëngjergj me shëndet
 Shkojnë malokët në vend t'vet⁴⁾

Karakteristike për kremtimet e Shëngjergjit janë kangët e shtregullës (argëtim i thjeshtë, që njihet me emna të ndryshëm në krahinat e atdheut (sh. muz. nr. 16).

1) nga italishtja "acquavite" d.m.th. raki

2) Nxjerrë nga *idem-ibidem*

3) Vështrimi simbolik i këtij zakoni asht ma se i qartë. Shtojmë se zakoni për të qëllue me shufra të blerueme dhe m'u "shpla" ose m'u rrokullisë në vesen e mëngjesit të kësaj dite, njihet ndër traditat e disa popujve t'Europës.

4) Nga Arkivi i Institutit të Folklorit; mbledhë nga Andrea Varfi

Laja laja curulaje!
Nesër mrama shkojm te daje
Daje vjen gja s'na bjen.

E thjeshtë dhe parake asht kjo kangë e rrethit të Koplikut. Të thjeshta janë edhe variantet e saj në Pukë e Malësi të Gjakovës:

Culahaje
Çom tu daje
Po na qet pite me skrraja]

Kangët ma të bukura për shtregullat e Shëngjergjit i kemi në Shkodër. Deri para pak vitesh, në çdo lagje të Shkodrës, shtregullat e Shëngjergjit sajoheshin në oborre të shtëpive: mbi degën e fortë të ndonjë peme të madhe hidhej një litar, i cili lidhej nja $\frac{1}{2}$ metri pezull mbi tokë. Aty ku lakohet litari i lidhun, shtrohej një qylym ose jastëk (nen të cilin futshin për ogur tre guraleca e një grusht bar të njomë); përfund shtregullës mbetej varë një copë litari, që shërbente si bisht për të tërheq atë e për ta vu në lëvizje. Në mbramje mblihdeshin rreth shtregullës banorët e lagjes. Së pari hypshin fëmijtë (zakonisht djemtë se "kështu asht mbarë" — thojshin plakat), ndërsa një nga të pranishmit kapte bishtin e litarit dhe fillonte me lëkundë shtregullën tue ligjërue:

Hovi i madh	Nen kumbull
Hovi i vogël	Nen mand
Tue shtetitë	Sot bajram
Nëpër Shkodër	Hopaa, hopaaa!

Pastaj vinte radha e të rritunve me kangë e valle plot ngjyra idilike: (sh. muz. nr. 17):

Hypa në bajam e kndova	Balli i shndritte porsi bora
Tek po vinte vetull-holla	Njate deshta njate mora.
Me bishtaleca si bolla	

E fillonte kangën ai ose ajo që lëkundej në shtregull, ndërsa të pranishmit përsëritshin çdo varg, çdo distik ose çdo strofë. Sa zbriste njeni hyptë tjetri ose tjetra. Seicili me kangë (sh. muz. nr. 18):

E bukura si skyfteri	Po na rri ku hinte borë
Po na del e bardha verë	E bukura porsi yll
E bukura porsi mollë	Si hana qi ndrit në pyll.

Shumica e këtyne vjershave flasin për përtërimjen e natyrës, për blerimin e bimëve ose të pemëve dhe për gëzimin e të rijve: (sh. muz. nr. 19).

[1] Culahaje (Tropojë), taravoj ose tariluçë (Lumë), kolovazë (Korçë), kuluvarçe (Berat), pelikurçë (Gjinokastër), lishurk (Peshkopi), shilarzë (Elbasan) — Nga rrjedhin gjithë këta emna? — Ende s'asht shkëqitë prejardhja e tyre, por këtu nenvizojmë vetëm trajten "shilarzë" për t'a krahasue me fjalën latine "oscillum" që kundrohej si mjet ogurmirë për bujqësinë dhe që lidhej me kultin e Bakut (shih N. Turchi: Attuale rito dell' oscillazione come residuo di un rito di purificazione per mezzo dell' aria" botue në "Atti del VII Congresso nazionale delle tradizioni popolari — Firenze 1959)

Mori ti molla jeshile

gjylsy me sy moj gjylsy me sy
A t'kam than moj mos u rritsh-e „ „ „
Gem as degë në rrugë mos qitsh „ „ „
Se vijn'djelt't-o aty pari

E u ngatrrrohet peshtemalli „ „ „ „ „

Në disa nga këto vjersha ndihet një notë e lehtë humori:

Ju zotni që rrini bashkë
U ka xanë nata jashtë
Ju zotni që rrini grumbull
U ka xanë nata n'lundër
Ju zotni që rrini tubë
U ka xanë nata në rrugë.

Disa nga këto kangë kanë pak a shumë tiparet narrative të balladave lirike:
(sh. muz. nr. 20).

Kur kam ken një her'i ri-e

Sa mir shkova me kojshi	lum-lumi	un
Me një vajz'xuna miksi	„	„
Gjith ditën na hijeve	„	„
Gjith natën gardhijeve	„	„
Tue i ra karadyzenit	„	„
E tuj bā kokrën e'hengut	„	„
Dikush erdhi e na pergjoi	mjer-mjeri	un
Nana vajzen e fejoi	„	„
E fejoi në Venedik	„	„
E xuni tjetër ashik	„	„
Zemra e me u disprue	„	„
Jaranësia më ka lshue	„	„

Me të njejtat jone këndohet edhe kjo:

Nen një rrasë e nen një taudë

Kishte ndej'nji zojë e randë	amana, aman
Me dallfes o në njen'anë	„
Avitu së ta godis	„
Largou djal se po m'shastis	„
Kenke nuri i bukuris	„

Argëtimi i shtregullave në Shkodër zgjatej deri në orët e vona të mbra mjes; madje, nganjëherë, shtyheshin me kangë e me valle deri sa zbardhte drita (sh. muz. nr. 21).

Shkapërceva i mal me borë
Më priti një djalë me dorë
Mos më prek o more djalë
Se jam vash' e pa kunorë
Sharto dardhën bashkë me mollë
Sharto dardhen venia fikut

Të miren nepja fisnikut
Porse ai fisnik mos kjoftë
Nëpër male di mënoftë
Raftë bora e muloftë
Raftë shi e zbloftë
Fryftë era edhe e rrxoftë
I raftë breshni e coptoftë

Siç u tha ma nalt, shumë kangë shtregullash janë plot me ngjyra idilike (sh. muz. nr. 22).

Ti në mollë e unë në mollë
Të dy jena bel-hollë
Ti në dardhë e un në dardhë
Të dy jena faqe-bardhë.
Ti në fik e un në fik

Shoqi-shojt jem ba ashikë
Ti në ftue e un në ftue
Të dy jena pa martue
Ti në pjeshkë e unë në pjeshkë
Do t'martohena në vjeshtë.

Shtregullat e Shëngjergjit ishin rastet ma të volitëshme për idilet e të rijve shkodranë, — idile që shpesh herë përfundojshin në krushqi. Prandaj populli e ka mbiquejtë Shëngjergjin "krushku i pranverës". Tashti shtregullat e Shëngjergjit janë braktisë pothuajse fare e na ka ngelë vetëm jehona e kangëve të tynë.

Po të shqyrtojmë veçantitë e këtij kremtimi, do të vërejmë mjaft mbeuturina nga *kulti i pemëve*, — kult shumë i lashtë, që e ka origjinën në epokën bujqësore-patriarkale. Disa mitografë janë të mendimit se shtregulla lidhej dikur me *kultin e hanës*, e pastaj me *kultin e Dionizit*. Simbas mentaliteteve primitive, shtregulla ndikon, gjoja, në rritjen e të lashtave; sa ma nalt që të shkojë hovi i saj, aq ma shumë do të rriten bimët. Sidoqoftë, kangët e bukura të shtregullave na sjellin jehonën e kremtimeve pagane të pranverës.

Mbas Shëngjergjit, vijnë kremtimet e stinës së verës. Në këtë stinë kemi së pari "Shëngjinin" (23-26 qershor). Karakteristikë e kësaj feste janë flakadajt ose "elëlicat", siç u thonë në rrethin e Pogradecit. Asht koha kur kositet bari e gruni. Në vigjiljen e kësaj feste fëmijtë e disa viseve të Toskënisë thurin kunorë prej atij bari që quhet "triko" dhe me to në kokë qarkullojnë nëpër fshatra tue këndue:

Triko, triko i Shëngjini
I shëngjini shkoi e vate
Po na vjen Zoti Shën Pjetër
I Shën Pjetër-o biri im
Kalle dorën e më qit
As të qit as të kllas

Po të shtie ndë kollas!
Triko, triko i Shëngjini
Se na vjen Zoti Shën Pjetër
I Shën Gjini arth e shkoi
I Shën Pjetri na afro!

Atë ditë barijtë e maleve të veriut bajnë kunora me tuba byku ose kashtë të lidhuna me kurpën; në mbramje, si mbyllin bagëtitë në vathë, kunorat i ndezin dhe i rrotullojnë mbi kokë. Pothuejse në çdo krahinë të vendit tonë, asht zakon që, sapo të fillojë me u errësue, të ndezin zjarre me dru, kashtë, byk, dëllija ose karthija. Rreth këtyne zjarreve mblidhen të rijtë, vallëzojnë dhe hidhen nganjëherë përmbi slakë. Edhe për këtë rast nuk mungojnë kangët dhe vjershat e posaçme. Ja një shembull që pat qëmtue në Lekurë të Sarandës albanologu danez Holger Pedersen:

I Shëngjin e i Shënpjetër
Ndina të hidhemi përpjetë
Pleshtatë e moratë
Na i marçin çorajtë²⁾

1) Nga "Visaret e Kombit" vëll. III. f. 131.

2) Nxjerë nga "Mbledhës të herskëm të folklorit shqiptar", vëll. I, Tiranë 1964

Asht një pamje vërtetë e bukur, të shikosh nga larg zjarret e Shëngjinit që flakërojnë nëpër terr, në brigje e kodra, tue ndëgjue britmat e hareshme të rinisë që këndon e vallëzon rreth tyne. Ngushtica e vendit nuk na lejon që t'i përshkruejmë hollësisht.

Kangët dhe vjershat për Shëngjinin janë të ndryshme, por shumica e tyne shprehin dëshira për bereqet, begati e sidomos për zhdurkjen e insekteve, si p.sh. ky motiv nga krahina e Devollit (sh. muz. nr. 23);

Pleshta babica
Pleshtat umarenica
Pleshta babica
Pleshtat zoinica
etj.

Rreth origjinës së këtij kremtimi janë shprehë mendime të ndryshme: disa dijetarë thonë se lidhet me kultin e diellit me që bie në solsticin e verës, kurse disa të tjerë e lidhin me zbulimin e zjarrit që siç dihet solli pasoja aq të randësishme në jetën e njerëzimit (shih J.G.Trazei: "Mithé ssur l'origine du feu" f. 273-9 ed. Payot, Paris). Studimet e reja mitografike e kanë lëkundë t'ashtuqejtunën "teori diellore" të këtij kremtimi me disa argumente bindëse: tue shqyrtue sidomos bestytinitë, gojëdhanat dhe mitet e popujve të ndryshëm lidhun me zjarrin, kanë arrijtë t'i kundrojnë doket e këtij kremtimi si rituale ose shorti të "pastrimit" (lat. "lustratio").

Sidoqoftë, ky farë kremtimi me zjarre, me kangë e me kërcime rreth tyne asht shumë i përhapun nëpër popujt e ndryshëm të botës, fakt që dëshmon për origjinë të lashtë. Emni i Shëngjinit i ka dhanë kësaj feste një farë ngjyre kristiane por nuk ia ka mbulue dot tiparet pagane. Që ky kremtim kundrohej nga kisha kristiane si mbeturinë pagane, na e dëshmojnë sinodhet e veçanta të shek. VIII t'epokës sonë, që orvateshin t'iandalojshin popullit.

Fill mbas Shëngjinit, në disa vise, kemi kremtimet blegtorale të "gojave", që lidhen me ngjitjen e barijve për të verue grigjet në bjeshkë, — dhe që në disa vise kanë repertorin e pasqëm ("kangët e karvajave"). Ja një shembull i qemtuem nga Shefqet Pllana në Drenovë të Kosovës, ku kanë arrijtë deri më sot disa bashkësi të mëdha familjare ose "Zadruga".

O tuna tuna vaja vaja
O sot ni jav'na vin karvaja
Eu vin karvaja tan tuj knue
O n'gur t'nuses me pushue
O buk me hangër — me tfillue
O sa ma shpejt teshat m'i prue
O nesër natje n'shpi me shkue
E kur t'dalin te dera e stanit
O tymyrmeç, moj, maja e malit,
E kur t'shkojm na te shpija!
O gzohen pleçt e gzohen thmija
O ne na dalin nanat para
O plot pshtjellatët molla e dardha
O prehet dashi — prehet dhija
O zihet mishi n'haranija
O piçet pitja në tepsija
O zihet maza në kusija
O thrrasim miç e thrrasim bija

E knojm kang'me çitelifja
 O tak e tuk kërset alltija
 A ha, se karvaja erdh te shpija
 Ji ja ooo — ji ja ooo!
 U u va ooo — Uu, va ooo

Këto farë kangësh këndohen nga fëmijët ose bareshat në një mënyrë të veçantë: tue ngacmue fytin me gisht për t'i dhanë zanit një dridhje artificiale. Kjo mënyrë e të kënduemit, që ushtrohet edhe nga vajzat e Postribës si dhe nga ato të Malësisë së Gjakovës¹⁾, njihet edhe në traditat popullore të disa viseve të trevës dinarike, gjithashtu në Turkestan e në Abisini²⁾. Nga sa dëshmojnë disa zbulime arkeologjike, që paraqesin pamje nga të kënduemit me gisht në fyt, duket se kemi të bajmë me mbeturina të një tradite vokale të lashtë: — Në British muzeum gjindet një basreliev asirian i mbretnisë së Kujunxhikut ku shihet një kortezh instrumentistësh dhe kangëtarësh, midis të cilëve njeni mban dorën te fyti për të dridhë zanin, ndërsa të tjerët përplasnin duert³⁾.

Në stinën e verës kemi edhe *Dordolecin*. Kur mban kohë e thatë, kur vapa e zhegu përvëlojnë e nuk shihet asnjë re në qiell, kur shiu nevojitet shumë për bujqësinë, sepse rrezikon të thahet bima ndër ara, fshatarët e viseve të ndryshme të vendit tonë bajnë "ronën" ose "dordolecin"⁴⁾: çveshin një fëmi lakuriq, e mbulojnë me gjethe e me barishte që nga koka deri te kambët, i japin në dorë një degë ferre dhe e tërheqin tue këndue derë më derë (sh. muz. nr. 24).

Rona-rona peperona
 Bjer shi në arat tona
 Të na rritet bereqeti

Të hajë gjithë mileti
 Bereqeti sa çatija
 Gruri sa ka perëndia.

Në çdo oborr ku futen fëmijët, i pret e zoja e shtëpisë me një enë uji të cilën e zbraz sipër dordolecit, ndërsa ky kërcen tue spërkatë trollin. Në këtë mënyrë (sipas parimit të magjisë imitative) ndjellin gjoja shiun që asht aq i dobishëm në verë. Pastaj amvisa u jep fëmijëve vezë, oriz, sheqer tëlyne, pemë, etj.

Edhe ky motiv ka shumë variante në Shqipni. Shembulli që sollëm asht marrë nga Bilishti (rrethi i Korçës). Një variant kolonjarë qëmtue nga ekspedita shqiptaro-gjermane, paraqitet me këto ndryshime në jone dhe në vjersha (sh. muz. nr. 25)⁵⁾.

Vjershat e disa varianteve pasqyrojnë edhe ndonjë anë të jetës shoqnore, me një notë dhimbsunije për "varfërinë" e shkretë. Nënvizojmë intonacionet lutëse në disa nga këto jone. Ja një shembull nga Devolli (sh. muz. nr. 26)⁶⁾.

Nganjëherë në vjershat e këtyre kangëve përzihen edhe elemente ndoshta totenistike si p.sh. në këtë variant nga Podgozhani i Mokrës (rrethi i Pogradecit) (sh. muz. nr. 27)⁷⁾

1) Dikur ushtrohej edhe nga femnat gjinokastrite, por tashti e kanë braktisë

2) Shih Walter Wiora; "Zur Frühgeschichte der Musik die dem Alpenlandern". Bale F. Kels 1949, f. 57

3) Shih Andre Schaefer: "Origine des Instruments de Musique" — Paris, 1936 f. 282

4) Në disa krahina i thonë edhe "xorxole".

5) Nxjerrë nga "Antologji këngësh popullore".

6) Nxjerrë nga idem

7) Idem — mbledhë nga ekspedita shqiptaro-gjermane.

Rona rona <u>paperona</u>	<u>hojlie</u>	hojlie	
Bjer shi nër arat t'ona	„	„	
Ku njëmij, e kutrulie	„	„	
T'i mbushi hambaret plot	„	„	
Shkon një zog, zog bishtë-bardhë	„	„	
Me një pollogë në gojë	„	„	
Një pollog'e dy tre okë	„	„	
T'i mbushi hambaret plot 1)	„	„	

Në disa vise të Gegënisë, kjo mbeturinë pagane ka arrijtë e gjymtueme. Edhe në rrethin e Gjakovës kemi kangë për shiun por pa "dordolec":

Fale o zot bereqet	U bāft sheka dymbdhet grosh
Sa mot, sa vjet	Dymbdhet grosh e dymbdhet pa
Elb e grun'e kallamoq	U bāft sheka kater pare.

Ja dhe një shembull nga Luma:

Shi, shi bereqet
Ma shum mot se sivjet
T'bahen arat bereqet.

Në Mat, fëmijtë ligjërojnë vjersha për shi tue tundë degët e pemëve:

O Zot bjerna shi
Të na baj' kallij të ri
T'a çojm në mulli
T'a blujm t'a bijm n'shpi
T'a gatujm t'a hajm me zemër t'mir²)

Pak a shumë kështu edhe në rrethin e Shijakut,

Shi, shi bubali
Bjere misrin me tre kallj.

Në të gjitha variantet shihet qartë karakteri bujqësor i këtij riti të lashtë, mbeturinë magjizmi. Simbas mitografisë, *dordoleci* i çveshun lakuriq dhe i mbuluem me fier ose me kingla e gjethe, përfaqëson "orën e blerimit", e cila, për kultin animistik të bimësisë, ushtron një ndikesë të dobishme, tue sjellë

1) Në një tjetër variant nga e naja krahinë, zogu bisht-bardhë cilësohet kësodore:

Një raheckë bishtë-bardhë	ojli e ojli
Një kallj e tre osmakë	„ „
Kujt një killë, kujt dy killë	„ „
Në fshat tonë 300 killë	„ „

Tek refreni i rrejshëm "ojlie" ose "hojlie" kemi nielljen ose një sinonim të vetë Dordolecit me që në disa vise të Maqedonisë e në trevë të Dibrës quhet "Ojlula" pikrisht "Rona" (shih Prof. M. Arnaudoff: ibidem)

2) Një variant që ka qëmtue Kahreman Ulqini po n'atë krahinë paraqet këto ndryshime:

Hej zot bina shi	N'magje t're e n'sofër t're
Se t'a hajmë për Shumri	Me sahana t'ri
Se t'a gatuejmë n'magje t're	Me lugjë të reja

gjoja shiun që rrit bereqetin dhe shton begatinë. Natyrisht populli e ka har-
rue tashma vështrimin e hershëm të kësaj dokeje të lashtë.

Shtojmë se kangët për shiun gjinden edhe në folklorin e popujve të tjerë,
si p.sh. te rusët ("dozhdik, dozhdik"); te bullgarët ("dordole" ose "papa-
ruga"), te rumunët ("dordolaia" ose "peperudë"), të grekët ("peperia"
dhe "dudule"), te sllavët e jugut ("dodole"), te turqit ("xorxole"), etj.
J. G. Frazeri në veprën e tij të mirënjohur "The golden bough" ka dhanë
mjaft shembuj nga viset e ndryshme të botës që nga veriu i Europës (me
"Jack-in — the Green" në Angli) deri në Afrikë, nga Amerika në Azi.

Kangë ritualistike për stinë e vjeshtës tash për tash nuk njohim me
gjithë kërkimet tona. Për të shpjegue deri diku këtë mungesë, duhet vu në
dukje, se gjermanët e hershëm njëfishin vetëm tri stinë: dimnin, pranverën
dhe verën. Me zhvillimin e bujqësisë i u shtue këtyne tri stinëve edhe vjeshta,
me që në tetor përfundojshin punët e mbjelljeve, korrjeve etj. dhe fillonte
periudha e pushimit (shih Fehrle: Feste ed usanze popolari tedesche f. 6.
cit. G.C. Pola: Associazioni giovanili e feste antiche — Loro Origini — vol-
III — f. 7). Mungesa e kangëve ritualistike për të kremtet e vjeshtës plotë-
sohet deri diku nga disa kangë ritualistike të dasmës që në shumicën e rasteve
baheshin në këtë stinë për arsye të ndryshme.

Tani të kalojmë te kangët e stinës së ftohtë. Në dimën kemi kryesisht
kolendrat ose *kullanat* që, me sa duket, lidhen me kultin e diellit dhe përbajnë
një repertor të posaçëm në të gjitha viset e Shqipërisë, natyrisht me ndryshime
simbas krahinave. Në Shkodër kangët e kullanave këndohen nga fëmijët
që bredhin derë më derë kur bie bora e parë (sh. muz. nr. 28).

Mirëdita për kullana
Me kupaca me sahana
Mirë mot e mirë sot-e
Na ndihmo i lumi Zot-e
Del e del e zoja e shpis

Me kunor t'zotnis
Del e del he kjosh e bardhë
Sot me barrë, nesër me djalë
A po del a po shkojmë?

Si mbaron kanga, del e zolja e shtëpisë dhe u jep fëmijëve "kullana"¹⁾.
Tue u largue s'andejmi fëmijët këndojnë edhe këtë kangë falenderimi (sh.
muz. nr. 29).

Njiktu kenka shej shej mire
Kali kam-bardh-e
Vithja e prarueme
Zoja e ngarkueme.

Por kur ndonjë amvisë nuk u jep asgja, atëherë fëmijët e shajnë pak a
shumë me të njejtat jone tipike ku mund të vërehen intonacionet e theksueme
në mënyrë thirëse:

Njiktu kenka' i pus me rika
Zojës s'shpis' i raftë pika
Njiktu kenka' i pus me rosa
Zojës s'shpis' i raftë qirosa

Njiktu kenka' i pus me pata
Zojës shpis' i raft lëngata
Njiktu kenka' i pus me pula
Zojës s'shpis' i raft gërbula

1) Në Shkodër fjala "kullana" asht përzie me kuptimin e pemurinave që dhurohen për
këtë rast. Po kështu arbëreshët e Italisë me fjalën "kullëna" qejnë një farë ambëlsine. Këtë
fjalë e kanë edhe shqiptarët e Ukrainës. E kanë gjithashtu disa popuj t'Europës së bashku
me repertorin përkatës, si p.sh. rumunët ("colinde"), bullgarët dhe sllavët e jugut ("koleda"),
rusët dhe çekët ("koliadka"), etj. Etimologjia e këtij emni asht nga fjala latine "Calendae".
Dihet, se së këndejmi rrjedh edhe emni i muejit *kallnor*.

Nëpër Toskëni kolendrat këndohen më 23-24 të dhjetorit nga djemtë që mbliidhen në ndonjë shtëpi ku lozin, këndojnë e vallëzojnë deri në mesnatë; pastaj dalin e trokasin me çomakë¹⁾ derë më derë tue këndue:

Kolendra, millendra	Bozhigrad e tutje
Qeni jashtë, macja mbrenda	Me djem e me nuse
Nëm moj hallë një kulaç	Nuset me cullufe
Se do vete Bozhigrad	Djemtë me baluke ²⁾

Si temë themelore kolendrat kanë urimet për mbarësi, begati, gëzime e lumtuni në familje. Nuk mungojnë gjithashtu vjershat tallëse për amvisat koprace. Në mbrendinë e tyne, me kohë janë futë edhe pjesë legjendare naive me personazhe biblike, — siç mund të shihet në këtë shembull nga rrethi i Lushnjës (sh. muz. nr. 30)³⁾. Midis fjalëve të pakuptim, vërehen elemente onomatopeike nga imitimi i shpendëve dhe kafshëve. Qëllimi i këtyne elementeve nuk asht "dekotativ" por magjik. Ja edhe një shembull nga rrethi i Korçës (sh. muz. nr. 31)⁴⁾.

Edhe kolendrat e arbëreshëve të Greqisë, që këndohen nga shqiptarët e Evia-s kur ngrysen nata e vitit të Ri, kanë një sfond fetar, por shumë ma të gjanë dhe njerëzor, — siç mund të vërehet në këtë shembull të qëmtuem në Kavo nt'Oro⁵⁾:

Mirë se na vjen Viti i Ri
 Mirë se të na pliqenjë⁶⁾
 Si nestër thonë palea⁷⁾
 Cili t'proto venij⁸⁾
 Derëve t'avloportëz⁹⁾
 Nga një dume¹⁰⁾ t'i jepni
 Pse isht klisia panigjiri¹¹⁾
 C'ish një njeri me areti¹²⁾
 C'ish shum glikomiri¹³⁾
 Një thatë dru keq për bastunij¹⁴⁾
 E kish për t'akumbishej¹⁵⁾
 N'mal në ket thatë dru¹⁶⁾
 Di zog eqelaidem¹⁷⁾
 C'kejnë sitë si diamandë¹⁸⁾
 Hrisaf n'fliuturave¹⁹⁾
 Ngrihuni, vlerëz, veshuni
 Në klishezë të venëj²⁰⁾
 Nga klishta t'mos lipseni²¹⁾
 Kali psih i t'kenij²²⁾

1) Çomage ose çamilgë, shkop me një gungë në kokë, që punohet qëllimisht për këtë rast ose blehet në pazar.

2) Qëmtue në Rehovë të Kolonjës nga ekspedita shqiptaro-gjermane.

3) Mbledhë nga Mustafa Bylo.

4) Mbledhë nga Koço Trako

5) Nxjerrë nga Jani P. Gjika: "Arvanitika Traghudhia toi Kavo nt'oro" Athinë 1962.

6) pelqejë

7) së lashti

8) Cili t'vijë i pari

9) d.m.th. n'derë t'oborrit.

10) dhuratë

11) panair kishtar

12) Na ishte një njeri me virtyte

13) fatbardhë

14) Kish për bastun një dru të thatë

15) që të mbështetej

16) Sipër ktij druni të thatë

17) Dy zogje ciccrojshin

18) Që i kishin sytë si xhevahirë

19) ar i kulluet

20) të vemi në kishë

21) mungoni

22) të kemi shpirt të mirë

Nga klisha molis dridhenj ¹⁾
 dhe në shtëpi të venj
 t'shtroni dhe trapeznë
 t'hani të t'pinj
 A nish te ndo një ftoho ²⁾
 T'hanjë edhe t'pinjë
 Mot e nga mot t'jemi mirë

Të thjeshta dhe parake janë jonet e kolendrave, me një shtrimje të ngushtë që rëndom rrafshohet në recitative e me një ritëm të qartë që përkon, shumë me motivet e mitunoreve. Prap se prap me gjithë thjeshtësinë e tyre janë shumë interesante për etnomuzikologjinë.

(Në kohën e kolendrave ³⁾, në Dukagjin e në Mirditë kemi "Natën e Buzmit" që lidhet me kultin e të parëve" (manizmi) dhe me atë të zjarrit. Këtu s'asht vendi të përshkruajmë hollësisht doket dhe bestytnitë popullore lidhur me këtë kremtim ⁴⁾, por asht e nevojëshme të parashtrijmë disa shkoqitje rreth kulteve në fjalë. Siç pamë ma nalt, populli ynë ka trashëgure nga kohët e lashta zakonet me ndez zjarre ose elelica në disa ditë të shënueme dhe me këndue e vallëzue rreth tyre. Por, ndërsa zjarret e verës dhe të pranverës ndizen jashtë, zjarri i natës së Buzmit ndizet në votër, ndoshta për arësyje të kohës së ftohtë, kështu që ka një karakter ma intim, ma familjar. Simbas disa dijetarëve, kulti i zjarrit e ka zanafillen në epokat parahistorike: — njeriu parak e kundroi zjarrit me poni, e deshti dhe e dreshti si dështa të hy-nushme. Dihet, se stërgjyshët tanë adhurojshin Enji-n si hyjni të zjarrit; së këndejmi kemi emnin e ditës së "enjtë". Dikur altari i këtij kulti u ba votra e shtëpisë, qendra e familjes. Populli ynë ka ruejtë ende disa teprica nga ky kult i lashtë — ende sot e dron dhe e nderon zjarrit; betohet për 'të, për flakën e tij, për "nurin" e tij. Madje malësorët e verit për natën e Buzmit i t'rejnë zjarrit d.m.th. i mëkojnë deri shujtë dhe ushqime.

Nëpër disa vise të Mirditës, kur kryefamiljari, në shej flijimi derdh gotën e rakisë me gjithë meze në çepin e drurëve që digjen ligjëron:

1) sapo të këtheheni nga kisha

2) E në goftë ndonjë i vorfën

3) Siç u pa ma nalt, data e kolendrave lëviz simbas krahinave: diku bie për vitin e Ri, diku për borën e parë e diku për këshnellë, — ndonse me sa duket kanë lidhje ma fort me kultin e zjarrit dhe me manizmin se sa me krishtlindjet (shih Ljly Weiser: Altgermanische Jungshnsweihe und Mamerbunde f. 9 — Baden 1927). Dihet se festa e krishtlindjes andej nga gjysma e shekullit IV, zuni vendim e festës pagane të Mitra-s (Natalis solis invicti), që simbas kalendarit romak binte me 25 të dhjetorit dhe që gabimisht mbalej si solstic i dimnit, por që në të vërtetë bie me 21 t'atij muaji, sepse që prej kësaj date fillon m'u zgjatë dita: — "këshnellë e verë" thotë një lokucion i popullit tonë. Këtë lokucion e sqaron paragjykimi se goja mbas këshnellave filluaka m'u zgjatë dita "sa kërcen gjeli tra më tra" —

4) Shih nga auktori i këtij studimi "Folklori ynë dramatik" (f. 113-114) botue në rev. "Nëndori" nr. 1, viti 1962, f. 84-139. Përsa i përket mbeturinave të Manizmit në këtë kremtim, shtojmë se nëpër malësi të verit dhe në disa vise të Kosovës, si hanë darkën e Buzmit, e lanë sofrën shtrurë gjithë natën, me dritë ndezë, sepse thonë se me këtë rast vijnë shpirtnat e të parëve. Përveç Manizmit, në fondin e këtij kremtimi shquben edhe disa rite bujqësore: atë natë shtrojnë rreth sofrës kashtë thekre, mbi të cilën ulen e rrijnë kur hanë darkën. Me atë kashtë pastaj bajnë tuba e kunora për t'ia varë të nesërmen pemëve frytdhanëse si t'i kenë kërcënuë me sopatë. Ky asht një ritual shumë i lashtë që ushtrohej edhe nga popujt e tjerë jo vetëm nëpër Ballkan por deri në veri të Francës (shih A. van Gennep: Le Folklore de la Bourgogne f. 118). Ky ritual ashtu si krejt kremtimi i buzmit të këshnellave njihet në traditat e shumë popujve t'Europës, — deomos me ndryshime nga njëni vend në tjetrin — si p.sh. në folklorin bullgar ("Budni veçar"), ose te sllavët e jugut ("bodnjak"), në disa vise të Francës (Cosse de Nou) dhe t'Italisë që nga Alpet deri në Sicilie, (ku buzmin e ndezën kryefamiljari me lutje e bekime të veçanta tue e spërkatë me venë. Duket se më këtë doke pagane lidhet pema e këshnellave ose e vitit të Ri në traditat e shumë popujve t'Europës.

- Sungu na e ka dhanë
 — Sungu le ta peije, — i përgjigjen një zani të pranishmit—
 — Toka na e ka dhanë
 — Toka le t'a peije

dhe vazhdojnë në këtë mënyrë tue përmendë mbas tokes qershinë, kumbullën, mollën, dardhën dhe pemët e tjera me radhë. Ja edhe një tjetër namatisje që ligjërojnë mirditorët me këte rast tue qërfate unët e buzmit për vargoj të votrës:

- Sa gjacullema dalin
 — Aq gjelm na u shtofshin
 — Sa gjaculleme dalin
 — Aq gjelm na u martofshin
 — Sa gjacullema dalin
 — Aq penë dhena u shtofshin
 — Sa gjacullema dalin
 — Aq penë që na u ngafshin
 — Sa gjacullema dalin
 — Aq barrë drithi gjeçim
 — Sa gjacullema dalin
 — Aq koshare u mush-shin
 — Sa gjacullema dalin
 — Aq kulla na grefshin
 — Sa gjacullema dalin
 — Aq kumonë tingllofshin
 — Sa gjacullema dalin
 — Aq sofra u shtrofshin;

Carani ose gjerma e votrës asht ende vendi ma i nderuem në shtëpitë e malësorëve tanë. Gjurmët e kultit të zjarrit mund t'i vërejmë edhe në shumë motive që nuk kanë lidhje me kolendrat, ose me ndonjë ditë të shënueme si p.sh. në këtë namatisje që ligjërojnë gratë matjane kur duen me ndezë zjarrin shpejt.

- Nizu zjarm e banu flakë
 Se t'arrëni e zeza plakë¹⁾
 Nizu zjarm e banu xixë
 Se t'arrëni e zeza shtrigë²⁾

Në disa vise kangët për zjarrin janë shartue me motive të punës, — sig dëshmon ky shembull i qemtuem nga Shefqet Pllana në Ferizaj të Kosovës.

- Kallu zjerm-e kapullar-e
 Ta çet dada ni laknur-e!

Ky laknuri pët për pet-e
 Jan tue pritën nizet vet-e

1) Duket se këtu kemi të bajmë me një figurë të paganizmit dmth. me "plakën e votrës" që mbikqyrte zjarrin e pashuem.

2) Mbledë nga K. Ulqini

Jan tue pritën nizet vet-e
Don me shkue n'pun ma shpejt : . . .

N'pun ma shpejt-e don me shkue
Nepër ara me punue

Me punue hiç pa u ndal—e
Për me korrën grun të bardhë.

Nuk po zgjatemi me variantet krahinore të këtij motivi, por vetëm shtojmë se populli ynë e mban zjarrin ende sot si ogurmire për bagëti e për bereqet: — nëpërmjet flakëve, trajtave të prushit, lëvizjeve të tymit, krismave të landës djegëse, etj. orvatet me parashikue ndonjë send për të ardhmen. Kështu p.sh. në Myzeqe, natën e vitit të Ri, kur mbliidhen rreth votrës njerëzia, mbas darke, e kanë si zakon që kryefamiljarët të hedhin në zjarr *për-cëllak* (një lloj bime me ferra) ose kokrra gruni, tue përmendë me radhë emnat e pjesëtarëve të familjes. Sa ma shumë që të kërcasi e të hidhet përcëllaku ose gruni në zjarr, aq ma shumë gëzohen, sepse e marrin si paralajmërim mbarësije. Përveç njerëzve, e hedhin edhe për blegtorinë. Kurse përmetarët djegin dëllija tue bërtitë:

Olek, bolele
Plot me buk e bereqet
Me hambarë e me qilarë
Me nuse e djem gëzuar.

Në Shqipninë jugperëndimore (në rrethin e Sarandës), "për të martuar zjarrin" hapin një gropëz në prush, hedhin aty fletë ullini, dafina ose bobokuqe dhe ligjërojnë këtë distik:

Bobo-kuqe therimi
Dafinë edhe ulli.

Në qoftëse fleta kërcet e marrin si paralajmërim mbarësie.¹⁾

Përveç motiveve ritualistike që u parashtruen, në folklorin tonë kemi edhe kangë e vjersha të posaçme për muejtë e vitit siedhe për disa fenomene të natyrës. Do të nevojiteshin vëllime po të hyjshim me rreshtue këtu të gjitha motifet e ndryshme së bashku me doket përkatëse. Po çekim vetëm disa motive për hanën.

Dikur, për popullin tonë, fazat e hanës ashtu si ndryshimet e stinëve të vitit, kishin randësi të madhe qoftë për mbjelljet, korrjet, vjeljet, etj. ashtu edhe për punët blegtorale; prandaj janë sendërgjue me kohë doke dhe kremtime të veçanta së bashku me repertorin përkatës.

Hanë moj hanë e re
Un tu rrit'e ti tu nejtë

Këtë distik i a ligjërojnë fëmijët e Perlatit (rrethi i Mirditës) hanës së re tue vallëzue pupthi me duer në ijë. Një variant i këtij motivi, qëmtue në rrethin e Elbasanit²⁾, paraqitet ma i plotë:

1) Ndivnime të këtilla ushtrohen edhe nga popujt e tjerë, p.sh. të rijtë e disa viseve të Francës parashikojnë fatin e martesave nga mënyra se si digjen në zjarr gjetheet e bushit (shih A. v n Genepp. — ibidem f. 118)

2) Q. Guranjaku — Arkivi i Institutit të Folklorit.

Hanë, hanë	Un shëndet
Hanë e re	Ti si drapër
Ti e ré	Un si gjarpër
Unë e re	Ti si shkop
Ti si rreth	Unë si top ¹⁾

Të panumurta janë namatisjet, kangët dhe bestytnitë e popullit tonë lidhun me hanën²⁾, që në shumicën e rasteve përfytyrohet si qenie e gjallë pak a shumë në përgjasim me njeriun. Edhe këtu verehen mjaft mirë mbeturinat e botëkuptimit *animistik*.

Duhet përmendë edhe kremtimet tipike të "pajtorve" të disa katundeve ose krahinave; por tue qenë se nuk i përkasin një shtrese të përbashkët dhe për ma tepër rrallë herë paraqesin një repertor kangësh ose vjershash të veçanta, mendojmë se përshkrimi i tyre i takon ndonjë studimi mitografik.

Siç u tha gjatë parashtrimit të landës, shumica e këtyne motiveve kanë stinën e tyre dhe zakonisht nuk këndohen as nuk ligjërohen jashta rretheve përkatëse. Nganjëherë përzihen ose shartohen motivet midis tyre si p.sh. ata të ditës së Verës me ata të Shëngjergjit, ose llazoret me rusicat etj. Edhe datat e disa kremteve lëvizin pak a shumë simbas hanës (fenomen i njohun për folkloristët) tue e ngatërrue çeshtjen e hulumtimit të tyre.

Përsa i përket shtrimit ose përhapjes së këtyne motiveve mund të themi, se disa prej tyre gjinden (natyrisht me ndryshime) pothuajse në të gjitha krahinat e Atdheut sidhe në shqiptarët përtej kufinit; ndërsa një pakicë nuk gjinden në çdo trevë; ky fakt nuk e cenon unitetin tonë etnik. Sa më shumë që të gjurmohen traditat popullore aq ma shumë del në pah shtresa e përbashkët. Përgjithësisht këto kangë e këto vjersha janë ruejtë ma mirë nëpër katunde se sa në qytete; dhe kjo asht e kuptueshme si për lidhjet gje-netike që kanë këto motive me sferën blegtorale-bujqësore, ashtu edhe për vetë qëllimin e tyre lidhun me punët e fshatarësisë. Tiparet fshatare dhe qëllimi praktik i kangëve ritualistike janë të dukëshme në shumicën e rasteve, ndonse nganjëherë paraqiten si namatisje ose si ligjërime magjike pa ndonjë

1) Edhe ky motiv asht shumë i përhapun nëpër vendin tonë, — siç dëshmon ky varian nga malësitë e veriut, i cili na paraqitet me fare pak ndryshime:

Hanë e re, Hanë e re
Ti në qiell e un në dhe
Ti si drapën, un si gjarpën
Kur u çosha, mos pritofsha
Ti si grep, un shëndet
Ti si kizë, un si mizë

Plakat thonë se asht keq m'e pa hanën e ré ndejun por duhet m'u çue në kambë me të shpejtë e me ligjërue vjershën e masipërme tue kërcye. Prandaj kur sholin hanën e re, gratë dhe fëmijët e malësive kërcëjnë e këndojnë me gëzim. Nga kjo bestytni kuptohet edhe vështrimi i vargut të IV ("kur u çofsha mos pritofsha!")

2) Simbas plakave bestytnore na qenka mirë me hangër pemët e para të çdo stine (me i ba me shendet") vetëm me hanë jashtë, tue ligjerue këtë distik:

Me shëndet e hana jashtë
Zemra na e dashtë

Fusharakët e Nënshkodrës jikur i tregojshin hanës së re qesen e pareve. Gjurmët e kësaj bestytnie kanë ngelë në këtë vjershë që ligjërojnë fëmijët:

Hana e re buka e re
M'i qit paret qi m'i ke
Ne m'i dhaç, ne mos m'i dhaç
Ha buk e kulaç

kuptim. Shumica e tyre janë plot me elemente nga jeta e fshatit. Në kangët e kremtimeve pranverore shprehet kënaqësia për stinën e bukur, natyrën e përtrimë dhe sidomos gëzimi i bujktut dhe bariut që shpëtuën prej dimnit së bashku me bagëtinë. Po kështu në kangët e dordolecit shprehet kryesisht derti i bujktut për thatësinat. Tue qenë të pafuqishëm përballë fenomeneve të natyrës, bujqit e herëshëm sendërgjuen dikur shumë bestytini dhe rituale me një repertor kangësh të posaçme për shiun — aq i nevojshëm si për bimët ashtu edhe për jetësën e shumë viseve, ku burimet dhe vadat nuk mjaftojshin.

Shumë nga këto motive i kanë motërzimet edhe në traditat e popujve të tjerë. Një punë krahasuese me landën e traditave të hueja do të vlenë shumë për të sqaruar ose për të zhdrivilluar disa çeshtje të ngatërrueme dhe për të hulumtuar prejardhjen ose zanafillen e largët të motiveve; por kjo punë i kapërcen synimet e këtij studimi. Sidoqoftë, thelbi i përbashkët i shumë motiveve në traditat e popujve të ndryshëm dëshmon mbi lashtësinë e origjinës së tyre¹). Për këtë na bind edhe morfologjia e tyre me veçoritë stilistike, mjetet e shprehjes etj. që na kujtojnë nganjëherë gjendjen e poezië dhe të muzikës në periudhën fillestare të zhvillimit. Natyrisht, këto kangë që i përkasin shtresës ma arkaike të folklorit tonë, tue kaluar gojë më gojë, kanë pësuar mjaft ndryshime: — diku janë cungue, diku janë pajisë me shtojca të mëvonëshme përveç atyne që janë zhdukë e harrue fare goftë për arsye të kohës së gjatë, goftë nga fushatat e klerit kundra mbeturinave pagane. Siç dihet, ma parë , sidomos gjatë mesjetës, kisha, që synonte të çrranjoste nga populli çdo mbeturinë të paganizmit, u përpoq t'i zhdukte edhe këto kremtime së bashku me repertorin përkatës. Por megjithë ndjekjet, ndalesat dhe fushatat e klerit, shumë nga këto kangë qëndruen deri më sot; madje disa nga ato u përvehtësuen nga kisha që i ndryshoi pak a shumë në përshatje me kërkesat e saja. Kështu në vjershat e disa kangëve të kësaj gjinie depërtuen elemente monoteiste, si p.sh. Ristozi (tjetërsim i fjalës "Kristos" = krisht), Shën Ilia në Llazore, Shën Gjergji në kangët pranverore, Shëngjini në motivet e elicave të verës etj. Megjithatë, elementet e natpërmenduna nuk i mbuluan dot tiparet e tyre, kështuqë nën cipën monoteiste dhe politeiste shpesh herë mund të shquhet nenshtresa e kulteve ma të lashta.

Vjershat e kësaj gjinie, në shumicën e rasteve, janë të shkurta. Ato rrallë herë tubëzohen në strofa. E shkurtë asht zakonisht edhe masa e vargjeve të tyre që shtjellohen në një larmi kambzash metro-prozodike të mahnitëshme²). Shprehjet onomotopeike me imitime shpëndësh dhe kafshësh u a shtojnë harmoninë asonancave, aliteracioneve dhe gjasëramjeve — ndonse qëllimi i tyre asht ma fort simbolik. Pranë këtyne elementeve dhe pranë urimeve për begati, shëndet dhe gëzim, shihen shumë fjalë t'errëta pa kuptim, — ndoshta mbeturina formulash magjike. Kundrue nga ana estetike, nuk paraqesin ndonjë bukuri të madhe, me përjashtim të disa "valleve"³) nga repertori i shtregullave të Shëngjergjit që shquhet për një farë

1) Pra këtu pajtohem me mendimin e folkloristit italian Vittorio Santoli simbas të cilit këto farë kangësh dhe vjershash na qenkan «generi recenti anche se si riferiscono ed usi molto antichi» (shih V. Santoli: I canti popolari italiani — ricerche e questioni — f. 119 — Firenze 1940).

2) Tue qenë se këtu synuam me parashtuar kryesisht tematikën e motiveve së bashku me doket përkatëse, nuk po zgjatemi me shqyrtime të hollësishtme rreth veçantive morfologjike të shembujve që u çekën: kjo punë i takon studimeve të veçanta t'etnomuzikologjisë.

3) Kangët e shtregullave në Shkodër quhen «valle» ndonse nuk vallëzohen por vetëm këndohen tue u lëkundë në shtregull. Ky emërtim ose ky cilësim rrjedh ndoshta nga ajo fazë e lashtë e mendorisë artistike kur muzika, poezia dhe vallzimi përbajshin një triade të pandame.

lirizmi. Pavarësisht nga ana estetike, shumë kësi motivesh që u përkasin shtresave arkaike të folklorit tonë, paraqesin vlerë shkencore edhe për shprehjet parake të poezisë dhe të muzikës¹⁾. Nuk mungon as hijeshia poetike në mbreadinë e disa vjershave. Mjaft kangë të kremtimeve pranverore shquhen për frymën lirike që i përshkon, ato janë plot me gjethe, lule, flutura zogj e elemente të tjerë nga stina e bukur; ato janë sidomos të mbushuna me gëzimin e natyrës së përtrime. Karakteri lirik i vjershave të këtyne kangëve ka ndikue edhe në profilin e qartë të joneve përkatëse. Siç u theksue gjatë parashtrimit të landës, disa kësi motivesh këndohen, kurse të tjerët ligjerohen. Stilet e ligjerimit të tyne janë disa farësh: përgjithësisht enden me intonacione të bisedës por një bisedë e ritmueme dhe pak a shumë e kancueme. Përsa i përket joneve, shumica e tyne paraqiten me një ndërtim fare të thjeshtë elementar, me një shtrimje të kufizueme dhe pa zburkime. Rëndom përngjasojnë shumë me jonet e *mitulloreve*, ndoshta sepse shumica e tyne kanë përfundue në gojën e fëmijëve; në këtë rast, struktura e tyne duhet të ketë pësue një farë thjeshtësimi në përshtatje me mundësitë e fëmijëve, tue u pajisë nga ana tjetër, me një farë gjallnie të gëzueshme. Ritmika e tyne zakonisht e qartë ndahet ma fort në masa të rregullta në përputhje me cilësinë e kamzave të vjershës tue ndikue shumë në përcaktimin e trajtës së këtyne joneve. Përsa i përket fakturës së tyne, mund të themi, se shumica këndohen në unison, por në Shqipninë e Jugut nuk mungojnë edhe rastet e një polifonie rudimentale, — siç dëshmojnë shembujt që u çekën. Shqyrtimi i hollësishtëm i veçorive muzikore të këtyne kangëve i parashtron muzikologut një seri çështjesh interesante. Nepërmjet të tyne Etnomuzikologjia mund të depërtojë ndër shtresat arkaike të folklorit. Me gjithë parabolën organike që duhet të kenë përshkrue për të arrijtë nga zanafilla e tyne e lashtë deri tek ne, nëpërmjet sa e sa breznive që i përcollën gojë më gojë tue i ndryshue pak a shumë si në trajtë ashtu edhe në përmbajtje, prap se prap ato kanë ruejtë diçka nga koha e prejardhjes së tyne.

Tashti, shumë këso dokesh e kremtimeesh që i qëndruen shekujve, po zhduken bashkë me repertorin përkatës, sepse rryma dinamike e kohës së re po i fshinë dita ditës ma me shpejtësi. Prandaj duhet të nxitohemi që t'i qëmtojmë e t'i shpëtojmë nga harresa këto përmendore të vjetra të krijimtarisë sonë popullore, që na sjellin jehonën e kremtimeve të stërgjyshëve tanë e që na japin mjaft landë të çmueshme rreth botëkuptimit, dokeve dhe kulteve që trashiguem nga të parët.

1) Folkloristët që kërkojnë ndër kangët popullore kryesisht bukurinë poetike-muzikore dhe jo landën e çmueshme për shkencën, nuk e përfillin zakonisht këtë «gjini minore» që i intereson ma shumë dokeve se sa poezisë popullore» (sic!) — shih V. Santoli: ibidem 149-150

Andante (♩ = 90) SHEMBULL MUZIKOR NR. 1

Die...llo die...llo hidh-na një thes miello të mantoj-më
 la-lë-në la-lë kë-mbë çu-lë-në që na bëri djo-lë-në
 në kri-e të va-trë-së

Andante (♩ = 160) SHEMBULL MUZIKOR NR. 2

o zog- i fe-rres o - ho na(j)erdh dit-e
 ve-rës ia - ho Di-ta ve - rës erdh e shkoi-e

lu-mi aj aj o di e për-xhoi lu-mi aj aj o di
 e për-xhoi

Moderato SHEMBULL MUZIKOR NR. 3

o-re zogu.i fe-rres na(j)erdh dita ve-rës

Andantino (♩ = 66)

SHEMBULL MUZIKOR NR. 4

O ve-ra ve-ra ko-ko-ve-ra ve-ra ve-ra
 ve-ra ko-ko-ve-ra e
 ko-ko-ve-ra o ve-ra ve-ra ko-ko-ve-ra majtonj e u-
 ko-ko-ve-ra e u-
 -ru-a rë o maj zö-një u-ru-a-rë fle a-
 -ru-a-rë ru-a-rë

no jo zgju-a-rë o fle a no je zgju-a-rë
 je zgju-a-rë je zgju-a-rë

allegro

SHEMBULL MUZIKOR NR. 5

vera vera kokove-ra një pulë që pas e thera gjithë miqtë
 se ç'i ftova karkalecin e ha-rova karkalec o derë zi ç'ha ti
 z pi ti? ha-nish' aiarpë-ri ni u-jë bashë-ri

Parlando

SHËMBULL MUZIKOR NR.6

Marsh morrat e plehtat gjumin e - bahut E that e veres
me sakiza de-rës

All Gusto

SHËMBULL MUZIKOR NR.7

Dallandyshe faqe kuqe merr veroret shko në det sill tri qerre me shendet

SHËMBULL MUZIKOR NR.8

Dallandyshe buku-roshë sqep-gjylparë bisht gërsherë Na këto vero-re

Të na shpesh në det Të më sjell buk e - dhe shëndet

SHËMBULL MUZIKOR NR.9

llazore llazore fali xotit fali - e Ai na bani neren neren akso,
verës - e oj, halle oj, ta-palle Kogaren e pulës bardhë Kusto nëpër fusha
oj, teze oj, teze Kogaren e pulës zeza Ferra nëpër ferrë
m'u grisen bre-ku-shat
m'u grisen o-ne-part

Moderato

SHEMBULL MUZIKOR NR.10

O Lla-zo-re Llazoriska Ko-qe-ren qi ban lariska Në ma
dhanc ni kokër ve çuni jot marrt nuse l're

SHEMBULL MUZIKOR NR. 11

zere usta de-re desem-no zere usta nopruno fhi trendafite
ko ja-re mangëri-to Edhe motin me shëndet Lla
zoret gëzu ut gëzuar

SHEMBULL MUZIKOR NR.12

Edhe moti me shëndet llazore u qecim gë-zu-a-
lla-zore çim gë-zu-a
ner finire
rë lla-zore lla-zore
rë lla-zore lla-zore

SHEMBULL MUZIKOR NR.13

Duret e lla zoris-e e hangshin gja'ne motit e hangshin gja'ne motit

Largo ($\text{♩} = 60$)

SHEMBULL MUZIKOR NR.14

o mi ré mbra-ma usaj zotëri që ndë kte shp
no - dhet u thom? që që fa-mo-smë bë. Pe
ren - di - - - - a tek a - jo ho - ré që thon Betria
Tek a - jo ho - - ré që thon Betria

Allegretto

SHEMBULL MUZIKOR NR.15

Ru - sa pa - pu - sa Na dërgoi Ru - si - ca për një dockë miell

Të bëjmë ku - la - ce kulçe po - ga - ce Dil moj faqe bardhe
me një djulë


SHEMBULL MUZIKOR NR.16

Laja laja curu - la - ja Nesër mroma shkojm te daja daja vjen gja sha bjo

Moderato

SHEMBULL MUZIKOR NR.17

Hy - pa rë be - - - - - jam e Knda - va tek po vinte



Allegretto SHEMBULL MUZIKOR NR.18

o e bu-ku-ra si sky-fe-ri e buk-ru

o e bu-ku-ra si sky-fe-ri e buku-ra

Allegretto SHEMBULL MUZIKOR NR.19

mo-ri ti mo-lla je-shi-le gjyl-sy me sy moj gjyl-sy-me

sy o mo-ri ti mo-lla je--shi-le gjyl-syme -sy moj

gjyl-sy me sy

D.C.

Moderato SHEMBULL MUZIKOR NR.20

ut

oh kur kom kën një her' i ri-e lum lumi un

oh kur kom kën një her' i ri-e lum lumi un

Moderato

SHEMBULL MUZIKOR NR 21

Shka - per - ce - va i mal me bo - re

shka - për - ce - va i mal me bo rë

D.C.

Alliegretto

SHEMBULL MUZIKOR NR 22

Ti në moll - e un në moll - e

Ti në moll - e un në moll - e

D.C.

Vivace

SHEMBULL MUZIKOR NR 23

Meshta ba - bi - ca pleshta

SHEMBULL MUZIKOR NR 24

Rona tona pepero - na bjer shi nder arat tona

Të na rritet
Bere - qeli

bere qeli) që, të haja gjith mileti
na qelija) gruri sa ka nerëndi

Andante **SHEMBULL MUZIKOR NR 25**

Ro-na ro-na peperona Bjerë shi ne arat tona
 Të na bëhet misërija Që të hojë varfë-rija Të na behet bereqeti
 Që të honë gjith mileti

SHEMBULL MUZIKOR NR 26


Ro-na ro-na tri pe-rona bjerë shi de arat tona
 të na ritet bere qeti më shu-më gru-ri se thekri
 vaj, vaj do do-le vaj vaj do do-le

Allegretto **SHEMBULL MUZIKOR NR 27**

Rona, ro-na pe-pe-ro-na hoj-li-je hoj-li-je

Allegro **SHEMBULL MUZIKOR NR 28**

Mir-di-ta për ku-lla-na Me ku na-ca me sa-ha na Mir mol e mir
 sot-e Na ndih mo oi lumi sot-e dele del e zoja e shpis me kunor të zotnis
 del e del e kosh e bardh sot me derr nese me dja?



SHEMBULL MUZIKOR NR.29



SHEMBULL MUZIKOR NR.30



SHEMBULL MUZIKOR NR.31



BIBLIOGRAFI E SHKURTË

1. Alberto M. Cirese: Canti popolari delle colonie albanesi del Molise-Rieti 1957
2. Giuseppe Cocchiara: Storia del folklore in Europa — Torino 1952
3. James G. Frazer: The Golden Bough-Londër 1922
4. Emanuele Giordano: Folklore albanese in Italia — Ejanina — Frascineto 1957
5. Jani P. Gjika: Arvanitika Tragudhia toj Kavo nt'Oro-Athinë 1962
6. Georg von Hahn: Albanesische Studien-Jena 1854
7. Raffaele Petazzoni: Antichi Culti solari nella penisola balcanica në "Revista d'Albania" fash. VI — Milano 1941
8. G.C. Pola: Associazioni giovanili e feste antiche — Loro origini — vol. I-III — Milano 1943
9. T.V. Popova: Ruskoe narodnoe muzikalnoe tvorčestvo — Moskë 1955
10. Pietro Scotti: Etnologia — Milano 1941
11. Ramadan Sokoli: Kulte të lashta ndër bestytnitë e popullit tonë — (inedit pranë arkivit të Muzeut Etnografik — Tiranë)
12. Guglielmo Schmid: Storia comparata delle religioni — Brescia 1938
13. Rrok Zojzi: Gjurmët e një kalendari primitiv në popullin tonë. — në rev. "Buletin i Institutit të Shkencave" nr. 1. f. 85-112 — Tiranë 1949
14. Antonin Vaclavik: Vyraeni obycej a lidove umeni — Pragë 1959
15. W. Wundt: Völkerpsychologie — Leipzig 1912

R é s u m é

LES CHANSONS RITUELLES DES FÊTES DE L'ANNEE EN ALBANIE

Notre folklore garde toujours un grand nombre de vestiges de coutumes et cultes anciens qui se font accompagner par des chants et des danses particulières. Pour les spécialistes de ce domaine, notre pays, qui offre une grande variété folklorique et géographique, peut être comparé à un musée vivant. On peut y voir les diverses phases de la préhistoire, puisque l'on y trouve des traces vivantes de l'animisme, de la magie totémique, du fétichisme, etc. Encore de nos jours on entend certaines chansons qui portent l'écho des fêtes païennes et pré-païennes.

Le présent essai de R. Sokoli donne, pour la première fois dans l'ethnomusicologie de notre pays, le contenu de ces chansons qui offrent clairement des aspects rituels: il y analyse le sens de plusieurs célébrations annuelles de notre peuple. La plupart des données c'est l'auteur même qui les a glanées dans des sources locales. Dans son exposition, il a inséré organiquement ces données, on se proposant de les embrasser dans leur ensemble d'une perspective unitaire. Il en émerge ainsi un panorama suggestif.

On sait que la nature occupait une place importante dans les cultes de nos ancêtres. Ils adoraient le soleil, la terre, le feu, les eaux, etc. qu'ils consacraient par des fêtes et des sacrifices, des chansons et des danses particulières, arrivées en partie jusqu'à nous. En partant précisément des traditions populaires vivantes, l'auteur se propose de reconstruire et d'élucider certains rites illyriques,

à partir du culte au soleil, sur lequel on a toujours plusieurs vestiges dans les légendes et les locutions populaires, dans les serments, les jeux d'enfants, les fêtes et même les chansons (ex. mus. 1).

Dans la partie où il expose le matériel, les chansons rituelles sont groupées d'après notre calendrier folklorique, à partir des célébrations de printemps ("Dita e verës" — le jour de l'été, 13-15 mars). Nombreuses sont les chansons (nos 2,3,4,5,6,7, 8), les coutumes particulières et les superstitions populaires de cette occasion. La plus intéressante est celle qui se rattache aux "Anthosteries" de la Grèce antique, c'est-à-dire les célébrations que dans la région du Mati s'appellent "dajlina". Les jeunes des campagnes courent les collines, munis de torches, entre chien et loup, en chantant des refrains typiques. Le peuple affirme que les torches et les feux de cette occasion sont allumés "pour y brûler les Kore" (les esprits malins).

La fête du Vangjelismo, qui a lieu le 25 mars, est une des plus caractéristiques de l'Albanie du Sud. Des comitives d'enfants courent les rues des villages, en mettant en branle des clochettes qu'ils pendent à leurs cous. Ils pénètrent dans les maisons en chantant et en faisant charivari pour chasser les reptiles.

La fête des Llazore n'a pas de date fixe: habituellement elle tombe au commencement du printemps. La veille de cette fête, des troupes d'enfants affluent dans les villages en chantant près des maisons (nos. 8,9,10,11,12,13,14). Ces chansons ont, dans la plupart des cas, des vœux pour des bonnes moissons. Les familles font des cadeaux aux enfants. Outre les chansons, dans ces occasions concourent également d'autres éléments variés. Intéressante est une ancienne coutume des femmes de Korçe qui font tourner une poupée en loques, représentant l'esprit démoniaque de l'hiver. Dans quelques villages, les troupes d'enfants sont masquées.

La célébration des Rusica est du domaine plutôt des femmes, des enfants tantôt avant, tantôt après Pâques. Elle est aussi caractéristique que les autres fêtes populaires. Dans certains pays de Korçe on habille une petite fille en épousée et on la promène avec un cabas, à chanter par feu et par maison (ex, mus. no.15). Très intéressante est une ancienne coutume de cette occasion toujours vivante, c'est-à-dire "l'enterrement de la mère du soleil". On confectionne un certain mannequin en terre glaise, on le met sur une civière et on le recouvre d'un suaire, tout comme les morts. Le mannequin représente la mère du soleil. Vers le soir, on sort du village et l'on va à côté du fleuve à l'enterrer. Après l'avoir recouvert dans la fosse, on fait le vocéro, en disant: "Mère, pauvre mère, le soleil est venu et ne t'a pas trouvée". Puis on distribue pour son âme aux assistants, du grain cuit. Comme l'atteste l'étymologie du nom (Rusica), il semble que cette ancienne célébration a des rattaches avec les Rosalia des Romains.

La Saint-Georges est un des nombreux sacres célébrés au printemps, avec un riche répertoire de chansons. Chaque maison est ornée de rameaux d'arbres et de fleurs qu'on met sur les portes et aux fenêtres. La fête s'amorce le matin par des coutumes superstitieuses, qui gardent plusieurs vestiges du culte des arbres. Caractéristique à cette fête sont les escarpolettes (shregullat) et les refrains auxquels elles donnent lieu (nos. 16,17,18,19,20,21,22), revêtues de nuances idylliques pour la joie des jeunes et le renouveau de la nature. Les escarpolettes de la Saint-Georges étaient jadis les occasions les plus propices aux idylles des jeunes, qui souvent se résolaient en mariage. C'est pourquoi notre peuple a appelé saint Georges "le paranymphe du printemps". Les refrains des escarpolettes portent l'écho des célébrations païennes et pré-païennes. Le nom de saint Georges a revêtu cette fête ancienne d'un certain aspect chrétien, mais sans lui recouvrir ses traits foncièrement païens.

Dans la saison d'été on a surtout la Saint-Jean (23-26 juin). Cette fête est caractéristique pour les grands feux de joie qu'on allume vers le soir. Autour de ces feux se réunissent les enfants et les adolescents, qui chantent et dansent.

Ils sautent jusqu'à ce que les feux des bûchers sont éteints. La plupart des chansons de cette célébration expriment le désir de faire disparaître les insectes.

Dans des périodes de sécheresse, alors qu'on a besoin de pluie pour les champs, les paysans de plusieurs régions préparent la Rona ou Dordolec, en dépouillant un enfant pour le revêtir entièrement de feuilles vertes. Puis, ils l'accompagnent par feu et par maison en chantant (ex. mus. 24, 25, 26, 27). Sur le seuil de chaque porte, les commères versent de l'eau sur la tête du Dordolec, en invoquant ainsi (d'après le principe de la magie imitative) la pluie.

Dans la saison froide (le 23-24 décembre en Toskëri, tandis qu'en Gegëni à la chute de la première neige) on a les Kolendra ou Kullana, assez répandues dans toute l'Albanie. Des troupes d'enfants se réunissent pour chanter par feu et par maison les refrains traditionnels (ex. nos. 28, 29, 30, 31). Le sujet fondamental des chansons de cette occasion est constitué par les vœux de fécondité et d'abondance, de joie et de bonheur en famille. Ils ne manquent pas également des satires pour les commères avares. Leur contenu a reçu, avec le temps, également des pièces légendaires à personnages bibliques. Parmi les mots dépourvus de sens on observe des éléments onomatopéiques: depuis l'imitation des oiseaux à celui des animaux. Le but de ces éléments n'est nullement "décoratif", mais magique. Les mélodies des Kolendra sont simples, d'un ambitus étroit, qui souvent s'aplatit dans la récitative. Quoi qu'il en soit, en dépit de la simplicité de celles-ci, les chansons sont intéressantes à l'ethnomusicologie.

Outre les chansons, l'auteur passe à examiner également le culte du feu et certains rites avec lesquels notre peuple célèbre la nature, les saisons, les différentes manifestations atmosphériques qui représentent des cycles périodiques, ainsi que certains corps célestes, notamment la lune. De celle-ci (selon les superstitions populaires) relèvent certains résultats de l'agriculture. Chez la plupart de ces chansons se reflète plutôt la vie des campagnes, où se sont conservées mieux les rites. Cela est tout à fait compréhensible aussi bien en raison des liens génétiques qu'ont ces motifs avec la sphère bucolico-géorgique que du but même de celles-ci, qui se rattache aux travaux des champs. Ces chansons qui appartiennent, naturellement, à la couche la plus archaïque de notre folklore, en passant d'une bouche à l'autre ont subi de sensibles changements: tantôt elles ont été amputées, tantôt on leur a adjoint des additions tardives, etc. Cependant, en dépit de la parabole organique qu'elles semblent avoir parcourue pour arriver de leur origine critique jusqu'à nous à travers une infinité de générations qui les ont transformées qui plus qui moins aussi bien comme forme que comme contenu, il n'en reste pas moins qu'elles ont conservé quelques chose du temps de leur origine: elles nous offrent donc assez de matière précieuse sur la conception des coutumes, de la mythologie et des cultes populaires de nos ancêtres.

En considérant ces chansons sous leur aspect esthétique, on peut déclarer qu'elles n'offrent pas de l'intérêt, à l'exception de quelques cas du répertoire des escarpolettes de la Saint-Georges, qui se font remarquer pour un certain lyrisme. Indépendamment de leur aspect esthétique, plusieurs de ces motifs offrent une valeur scientifique également pour leurs expressions élémentaires de poésie et de musique: leur morphologie avec ses particularités stylistiques nous rappelle de fois l'état de la poésie et de la musique dans sa période primaire de son évolution. L'examen détaillé de ces particularités soulève plusieurs questions intéressantes, de pertinence de la musicologie.

Devant de tels trésors, il n'est point à s'étonner que l'on assiste actuellement en Albanie à un travail énorme, de glane surtout. En fait, jusqu'à maintenant on manquait d'un essai de ce genre dans notre littérature ethnomusicologique. Même sous sa forme actuelle, l'article n'est pas un simple rangement des célébrations populaires et des chansons relatives, mais il veut être un premier guide à une compréhension pertinente, avec les données qu'il fournit et les recherches directes de leurs vestiges, avec l'explication des divers phénomènes.

Dans ces dernières années, sous la poussée de la révolution, on assiste à la transformation foncière de plusieurs de ces coutumes, de ces rites et de ces chansons, qui risquent par là d'être perdus à jamais. C'est pourquoi le problème de leur glane est des plus pressants pour notre folklore contemporain.